



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal i mbajtur më 29 prill 2022 në mbledhjen e IX-të (nëntë), të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VII.

Mbledhja filloi në orën 10;20 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës.

Gjithashtu në mbledhje i pranishëm ishte z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës së Podujevës, znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, drejtorët e Drejtorive (DBF, DPZHE, DPKGJ, DKA, DPUMM, DSHPMSh, DBPZHR, DA, DSHMS dhe DKRS)

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe përfaqësues të mediave lokale, disa zyrtar komunal dhe një numër i qytetarëve.

Rendi i ditës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke i përshëndeti të pranishmit, ndër të tjera theksoi, në bazë të listës së nënshkrimeve të pranishëm në sallë janë 34 anëtar/e të Kuvendit ndërsa për momentin mungon 1 (znj.Tringa Sfishta), andaj kuorumi ekziston për të vazhduar me mbledhjen. Para dy ditësh kemi mbajtur edhe mbledhjen e KPF-së nga ku edhe janë nxjerrë disa konstatime të cilat ju janë përcjellë gjithë anëtarëve të Kuvendit. Rreth rendit të ditës jeni në dijeni se është paksa i ngarkuar sa i përket numrit të madh të pikave, por besoj se çdo gjë do të shkoj mirë, andaj e hapi mbledhje, urdhëroni nëse ndokush ka diçka rreth rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, propozoj që pikat e propozuara të rendit të ditës si dhe të rekomanduara për mbledhjen e Kuvendit, si në vijim;

- *Rishqyrtimi i Vendimit nr.01-020/04-0014613/22 për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete, të miratuar nga Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2022.*
- *Rishqyrtimi i Vendimit nr.prot.01-550/01-0014605/22 për shpërndarjen e druve të zjarrit për familjet me gjendje të rëndë ekonomike, të miratuar nga Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2022*
- *Rishqyrtimi i vendimit nr.prot.01-354/02-0014599/22 datës 28.02.2022 për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr.01-354/02-0087371/18 datë 02.11.2018, konkretisht për objektin në fshatin Orllan*

Të kalojnë në 3 pikat e para të rendit të ditës meqenëse është konstatuar se ka pasur shkelje ligjore.

z.Naim Çunaku, theksoi, duke pasë parasysh atë që edhe Kryesuesi i Kuvendit e theksoj se e kemi një rend të ditës thuajse të ngarkuar, dua të përsërisë propozimin që e paraqitëm edhe në mbledhjen e KPF-së që të shqyrtojmë mundësinë që këtë mbledhje ta ndajmë në 2 pjesë, dhe për të qenë më i kjashtë, jo me qëllimin që të kemi seancë të re por që kjo që është thirr të ndahet për punime në dy ditë për arsye se ka shumë pika dhe janë disa vendime thuajse kruciale që do të merr ky Kuvend dhe që mos të na përsëritet praktike e seancës së 28 shkurtit 2022 e cila ishte po ashtu e ngarkuar dhe si rezultat i asaj kanë rezultuar edhe disa vendime në kundërshtime me ligjin.

Pra propozoj që ta ndajmë seancën në dy ditë pune.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, ne patëm dy propozime nga dy parafolësit, andaj i hedhim në votim propozimet e paraqitura, dhe atë duke filluar nga propozimi i parë që ishte për ndryshimin e renditjes së pikave të rendit të ditës, pastaj propozimin e dytë për ndarjen e kësaj seance në dy ditë pune.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 34 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent në sallë, 17 vota janë PËR, 17 vota KUNDËR, por duke shfrytëzuar të drejtën e votës së dyfishtë të Kryesuesit të Kuvendit në raste të tilla, e që ishte Kundër duke theksuar se e mbështes që të vazhdohet me punime sipas rendit të ditës dhe renditjes së pikave, nuk kalon propozimi i znj. Donjetë Sheqiri.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 34 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent në sallë, 17 vota janë PËR, 17 vota KUNDËR, por duke shfrytëzuar të drejtën e votës së dyfishtë të Kryesuesit të Kuvendit në raste të tilla, e që ishte Kundër duke theksuar se nuk mund të dal kundër një thirrje të rendit të ditës që e kam përgatitur dhe përcjellur unë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, pra meqë propozimet e parafolësve nuk morën votat e mjaftueshme dhe nuk ka këshilltarë tjerë për të marrë fjalën, tani e hedh në votim rendin e propozuar të ditës duke përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa-KPF.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 34 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent në sallë, 17 vota janë PËR, 17 vota KUNDËR, por edhe në këtë rast duke shfrytëzuar të drejtën e votës së dyfishtë të Kryesuesit të Kuvendit në raste të tilla, e që ishte PËR, miratohet rendi i propozuar i ditës duke përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së e mbajtur më 27.04.2022, me theks përfshirjen në kandër të rendit të propozuar të ditës edhe pikën shtesë dhe atë;

- *Rishqyrtimi i Vendimit nr. prot.01-354/02-0014599/22 datës 28.02.2022 për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr.01-354/02-0087371/18 datë 02.11.2018, sipas Shkresës nr. DL 1546-2/22 datë 25.03.2022 të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.*

1. Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më:

17 shkurt 2022; 28 shkurt 2022; 05 mars 2022 dhe 16 mars 2022

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, kemi 4 procesverbale nga mbledhjet e kaluara të Kuvendit të Komunës, andaj urdhëroni nëse ndokush ka diçka rreth tyre, nëse jo atëherë i hedh në votim në pako procesverbalet sipas thirrjes dhe materialit të dërguar për këtë mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 34 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 18 vota PËR, asnjë votë KUNDËR dhe asnjë votë të PËRMBAJTUR, miratohen në pako, pa vërejtje apo plotësim ndryshime procesverbalet sipas materialit përkatës të dërguar në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës.

2. Propozim Vendimi për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Podujevës për periudhën 2022 – 2030

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, jemi në dijeni se Harta Zonale është një prej dokumenteve më të rëndësishme që është sjellë ndonjëherë për shqyrtim dhe votim në Kuvendin e Komunës, kështu që duke qenë në dijeni se është një dokument shumë i rëndësishëm i cili ka kaluar të gjitha procedurat e kërkuara dhe është sjellë në Kuvend, për më shumë fjalën hyrëse ja jap drejtorit të Drejtorisë përkatëse.

z.Leutrim Krasniqi, U.D. drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit-DPUMM, përshëndeti të pranishmit dhe e paraqiti fjalën hyrëse rreth këtij propozim vendimi, ndër të tjera theksoi, më lejoni që para juve të paraqes draftin final të Hartës Zonale të Komunës së Podujevës 2022-2030, dokument ky i cili është një mjet për arritjen e qëllimeve dhe objektivave të parapara me Planin Zhvillimor Komunal-PZHK, përmes të cilit definohen më saktë Zonat e Banimit, të Bujqësisë apo aktiviteteve ekonomike e të tjera ku për secilën Zonë më saktë përcaktohen zonat e shfrytëzimeve të lejuara dhe ato të ndaluara të tokës, kushtet zhvillimore dhe ndërtimore si dhe masat e veprimit për periudhën së paku 8 vjeçare.

Pikënisja për hartimin e Hartës Zonale është Plani Zhvillimor Komunal i cili për vizion për Komunën e Podujevës ka aspiratat e zhvillimit social, ekonomik, mjedisor, të infrastrukturës etj.

Që nga hartimi i Planit Zhvillimor Komunal në vitin 2009 deri në vitin 2016 vërehen ndryshime në terren, nga ndërtimet e pakontrolluara dhe jashtë kufirit ndërtimor të përcaktuara me PZHK, kryesisht në banim, në ekonomi, me shtrirje në tokat bujqësore dhe arsyeja e kësaj ka të bëjë me mungesën e kontrollit të zhvillimit por edhe me përcaktimin e kufirit të tokës ndërtimore për zhvillimin e ardhshëm, dhe këto ndryshime janë të evidentuara në dokumentin e Hartës Zonale duke i përfshirë në Zonat përkatëse.

Harta Zonale nuk është një strategji e përgjithshme sikurse që është PZHK, por është një dokument i cili përcakton se çfarë ligjërisht mund të bësh me pronën, prandaj duhet të ketë një konsistencë ndërmjet shfrytëzimit të planifikuar të tokës dhe zoonimit në Hartën Zonale. Bazë për definimin e Zonave është harta e shfrytëzimit të tokës e PZHK-së, emërtimi i Zonave është bërë në bazë të Udhëzimeve Administrative si dhe në bazë të normave teknike të planifikimit hapësinor.

Harmonizimi i kërkesave të interesit publik me të drejtat në pronë private, promovimi i shëndetit dhe sigurisë publike si dhe kapaciteteve të shërbimeve dhe ndërtesave, janë marrë në konsideratë në përcaktimin e Zonës së banimit dhe Zonës së shërbimeve.

Zonat me vlera natyrore dhe të trashëgimisë kulturore si dhe sipërfaqet e mbrojtura ujore janë bazuar në parimin e sigurimit të mbrojtjes së karakterit natyror, historik, kulturor dhe peisazhor. Caktimi i zonës bujqësore dhe pyjore është bërë duke marrë parasysh karakteristikat natyrore të tokës duke përfshirë edhe përshtatshmërinë e shfrytëzimit të bazuar në karakteristikat e dheut, relievit si dhe ruajtjes së tokës kualitative. Kërkesat që vijnë nga ligjet përkatëse për mbrojtje nga ndotja e ajrit, ujit, mbrojtja e tokës, mbrojtja nga zhurma, masave mbrojtëse ndaj zjarrit, erozionit gjithashtu janë marrë parasysh në përcaktimin e zonës mbishtresore.

Definimi i shfrytëzimeve të lejuara, të lejuara dytësore, të lejuara të veçanta, të përkohshme dhe atyre të ndaluara si dhe i kushteve zhvillimore / ndërtimore në këto zona janë hartuar në përputhje me ligjet respektive dhe normave teknike të planifikimit hapësinor.

Pjesëmarrja publike gjithashtu ka qenë një proces shumë i rëndësishëm gjatë hartimit të HZK-së, e që edhe qytetarët e kanë mbështetur këtë proces. Vendimmarrjet për shfrytëzimin e tokës, do të kenë ndikim direkt në jetën dhe mirëqenien e banorëve të Komunës tonë si dhe në vlerat e pronave të tyre.

DPUMM është përgjegjëse për koordinimin dhe bashkëpunimin me Ekipën Komunale që do ta zbatojnë Hartën Zonale.

Me miratimin e HZK-së, të gjitha dokumentet e planifikuese, të nivelit të njëjtë dhe më të ulët nuk do të jenë më të vlefshme, nga hyrja në fuqi e Hartës Zonale.

Për fund ftoj të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës që ta miratojnë Hartën Zonale të Komunës së Podujevës, dokument ky që është mjaft i rëndësishëm për Komunën dhe i cili përcakton më ndryshe edhe një instrument kontrollues të shërbimeve të cilat janë duke ndodhur në vendin tonë.

z.Valon Demolli, në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së, theksoi, në qeverisjen e Komunës nga LDK ka filluar hartimi i dokumentit më të rëndësishëm për Komunën tonë e që është Harta Zonale e Komunës së Podujevës. Me ardhjen e LVV-së në Ekzekutivin e Komunës është bërë edhe plotësim ndryshimi i këtij dokumenti në vitin 2021, dokument ky i cili është përcjellë me paqartësi profesionale por edhe ligjore, dhe si i tillë ka dështuar në vitin 2021 të kalojë në Kuvendin e Komunës, mirëpo edhe sot ky dokument na vije në Kuvend për votim pa pasur konsultim publik, pa takim me qytetarë, pa takim me grupe të interesit ashtu siç edhe parashihet me baza ligjore.

Çka përmban ndryshe ky dokument me atë të përparshmin, përse nuk është publik për qytetarët versionin e fundit i Hartës Zonale si dhe sa do të jetë koeficienti i ndërtimit nëpër lagjet e qytetit.

Forma e dërgimit të këtij propozim vendimi ka rrezik t'ju përsëritet sikurse në vitin 2021.

Lidhja Demokratike e Kosovës ka qenë dhe do të jetë gjithnjë mbështetëse e propozim vendimeve që janë në interes të qytetarëve, por asnjëherë nuk do të bëhet pjesë e votimit kur Ekzekutivi i Komunës tenton që në formën që ka zgjedhur ta voton Hartën Zonale pa respektuar procedurat ligjore, andaj ne si grupi i këshilltarëve të Kuvendit nga radhët e LDK-së do të abstenojmë në këtë votim.

z.Florent Hasani, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së e mbështesim për miratim projekt Hartën Zonale të Komunës së Podujevës për periudhën kohore 2022 – 2030, pasi që është dashtë të bëhen disa ndryshime të vogla për të qenë në përputhje me planin hapësinorë të Komunës e që për të marrë vendimin e pëlqimit nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, për të ecë tutje me miratim në këtë Kuvend, sot e kemi mundësinë të gjithë që ta zhbllokojmë këtë proces më të rëndësishëm të Komunës së Podujevës duke votuar pro/për miratimit të Hartës Zonale e cila sërish po e rritet se është në përputhshmëri të plotë me Planin Hapësinorë të Kosovës dhe Strategjinë e Zhvillimit Hapësinorë 2010-2020.

z.Bashkim Sylaj, në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK-së, theksoi, Harta Zonale është një prej dokumenteve më të rëndësishme të Komunës tonë dhe mos procedimi për miratim që një kohë të gjatë i ka shkaktuar dëme të mëdha qytetarëve, bizneseve, gjithashtu edhe Komunës tonë.

Pëlqimin për miratimin e Hartës Zonale e ka dhënë edhe Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës e cila njëkohësisht ka kërkuar që dokumentet tjera t'i harmonizoj me gjendjen në terren si dhe të hartoj Planin Zhvillimor Komunal.

Ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së e përkrahim miratimin e vendimit për Hartën Zonale.

z.Leutrim Krasniqi, U.D. drejtor i DPUMM, theksoi, nga pyetjet e parashtruara nga anëtari i Kuvendit z.Valon Demolli, sa i përket draftit nga pëlqimi paraprak me këtë aktual që tashmë e keni para vetës, nuk ka ndryshime rrënjësore, në fakt ky draft përmban aspekte më të mira sepse është zgjeruar kufiri i Zonës Urbane në kuadër të Zonës ndërtimore, po ashtu pjesa tjetër e magjistrales Podujevë – Prishtinë që përfshinë territorin e Komunës tonë ka pasë pra aspekte të zgjerimit që i'u shërbejnë më shumë pjesës së tregtisë ose shfrytëzimit të përzier që mund të jetë banim.

Po ashtu të gjithë anëtarët e Kuvendit kanë qenë të ftuar të marrin pjesë në prezantimit të Hartës Zonale kështu që disa prej juve nuk keni ardh në atë takim.

Sa i përket pjesës së koeficientit të ndërtimit, në këtë aspekt ka qenë më ndryshe në draftin paraprak, mirëpo në bazë të normave teknike të planifikimit hapësinorë, indeksi i sipërfaqes së ndërtuar në kuadër të popullsisë që ka Komuna jonë është 3.0, nga kjo mund të jetë edhe një pjesë shtesë përmes bonusit e që shkon deri në 5.0, përndryshe është një pjesë e stimujve që i jepet ndërtuesve apo investitorëve të cilët dëshirojnë të zgjerohen në kuadër të sipërfaqes së ndërtimit.

Për më shumë edhe pëlqimi që është marrë nga MMPHI tregon se çdo gjë që është përfshirë brenda këtij dokumenti është bërë konform rregullave, prandaj po edhe nëse do të donim ne të veprojmë më ndryshe atëherë nuk do të lejonte kjo Ministri, pra mund të them se dokumenti është konform rregullave dhe ligjeve të planifikimit Hapësinorë.

z.Naim Çunaku, theksoi, më bëri përshtypje konstatimi i drejtorit parafoles i e potencoj se këshilltarët e Kuvendit gjegjësisht ne nuk kemi marrë pjesë në një takim informues. I nderuar drejtor i DPUMM, takimet me këshilltarët e Kuvendit të Komunës janë të rregulluara me akte normative, dhe një takim i tillë informues i planifikuar nga ana Juaj, për të mos hyrë në detaje unë personalisht kam qenë i interesuar për mbajtjen e një punëtorie ku do të dëgjonim fjalën e ekspertëve për Hartën Zonale dhe në një formë duke qenë shumë i vetëdijshëm se është një prej dokumenteve që përcakton orientimin zhvillimor të Komunës e që është nevojë imediate e Komunës, të gjitha këto më kanë bërë e që e ceka edhe në mbledhjen e KPF-së se si përbërje e Kuvendit të Komunës jemi këtu si rezultat i votës e jo si rezultat i ndonjë konkursi që duhet zgjedhur profile të ndryshme, dhe e vërtetë e madhe është që ne si Kuvend ende as persë afërmi nuk jemi të kompletuar siç do të ishte dashur të jetë një Kuvend dhe kur e them këtë e kam parasysh që ne si kuvend qysh në ditët e para të inaugurimit do të duhej të kishim të formuara Komitetet Konsultative dhe Komitetet tjera ndihmës që do ta japnin kontributin e tyre këshillëdhënës profesional, andaj në një punëtori të tillë sigurisht se do të merrnim pjesë.

Sa i përket asaj që po ashtu drejtori e ceku duke theksuar se çdo gjë është në rregull sepse nuk është ndryshuar Harta Zonale në një masë (ku ta dijë unë), do të doja të isha gabim por gjithçka që preket dhe kthehet, qoftë pak qoftë shumë, mendoj se ky dokument final ka qenë dashur që aty ku është ndryshuar të prezantohet edhe para qytetarëve gjegjësisht edhe para grupeve të interesit me qëllim që ta shohin se ku dhe çka është ndërhyrë.

Si do që të jetë, jemi këtu ku jemi në një seancë vendimmarrëse dhe të shohim tutje.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo nuk mbetet tjetër vetëm që propozim vendimin për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Podujevës për periudhën kohore 2022 - 2030 ta hedhin në votim.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 35 anëtar/e të Kuvendit të Komunës sa ishin prezent në sallë, me 17 vota PËR, asnjë votë KUNDËR dhe 18 vota të PËRMBAJTURA, miratohet propozim vendimi për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Podujevës për periudhën 2022 – 2030, sipas materialit përkatës të dërguar në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës për këtë mbledhje.

3. Propozim Vendimi për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2021 në vitin 2022 dhe destinimin në kategori dhe programe të caktuara buxhetore

z.Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, bartja e të hyrave vetanake nga viti paraprak në vitin aktual sipas këtij propozim vendimi është obligim ligjor i Ekzekutivit për mjetet e pashpenzuara në vitin paraprak konkretisht vitit 2021 e të cilat janë të realizuara si të hyra vetanake ku shuma është 1,032,341.89€ të cilat në projekte të vitit 2021 por që ka edhe mjetet të cilat barten për projekte të vitit 2020. Vlen të theksohet se nga shuma e cekur e të hyrave vetanake në vitin përkatëse diferenca e tejkaluar e planifikimit të të hyrave është mbi 340,000.00€ më shumë se sa kanë qenë të planifikuara dhe që nuk janë shpenzuar në vitin 2021.

Ashtu siç keni mundur ta shihni edhe në dokumentacionin e bashkëngjitur në propozim vendimin përkatës, mjetet në fjalë barten në tri programe, dhe atë në programin e administratës komunale ku janë të përfshira të gjitha Drejtoritë e Komunës, në programin e shëndetësisë dhe arsimit – kategoria e pagave ku është një shumë prej 3228.00€ dhe në kategorinë mallra dhe shërbime 14,115.25€, si dhe në programin e investimeve kapitale e ku vlen të theksohet se është një zvogëlim i shumës për 1.25€ në raport me atë që e keni në dokumentet e dërguara, pra është një shumë e cila më shumë ka të bëjë me barazime të bilanceve përfundimtare tek programet përkatëse në raport me shumën e përgjithshme.

Nga shuma e cekur, 360,864.55€ janë të ndara në programin e urbanizimit, pastaj për infrastrukturë publike janë 418,886.45, në arsim 60,466.73€ dhe shuma shtesë prej 12,402.25€ për mallra në arsim si dhe 1,713.00€ për arsimin parafillor, mandej në programin e shëndetësisë janë është shuma prej 59,805.00€, për paga në shëndetësi është shuma 3,228.00€ si dhe në programin e shëndetësisë - kategoria e subvencioneve është shuma 114,975.14€, andaj kërkoj nga Ju që ta mbështetni këtë propozim vendim në mënyrë që projektet që janë në realizim e sipër të përmbyllen edhe në aspektin buxhetor.

z.Demokrat Hodolli, në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së, theksoi, kjo tregon se ky Ekzekutiv nuk posedon aftësi profesionale të menaxhoj me të hyrat vetanake dhe treguesi më i mirë është kjo bartje e mjeteve buxhetore në kategori të ndryshme pa specifikuar saktë destinimin e tyre por duke lënë mundësi që të përdoren lirë e për lirë për t'i larë borxhet e fushatës dhe pazaret ditore. Pra kemi përshkrim, asfaltimi i rrugëve Burpcë, Letancë, Peran pa specifikuar cilat rrugë apo cilët trotuare, andaj kjo formë është veç një vazhdimësi e një qeverisjeje të dobët dhe pa vizion, prandaj Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së është kundër këtij propozim vendimi.

znj.Adelinë Stublla, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së e përkrahim dhe mbështesim këtë propozim vendim.

z.Bashkim Sylja, në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK-së, theksoi, lidhur me këtë propozim vendim edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa drejtori i DBF-së e ka sqaruar se shumica e këtyre projekteve janë vazhdimësi e projekteve të viteve të kaluara, kështu që ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së e përkrahim propozim vendimin për bartjen e të hyrave vetanake nga vitit 2021 në vitin 2022.

z.Fatlum Osmani, U.D. drejtor i DBF, theksoi, falënderoj parafolësit për diskutimet e tyre ku pati edhe kritika ku u përmenden disa çështje siç u tha paaftësi e realizimeve të buxhetit nga të hyrat vetanake, mirëpo mund t'ju përsërisë sërish se kemi një shumë prej mbi 340,000.00€ tejkalim i shumës së planifikuar nga të hyrat vetanake në vitin 2021, do të thotë kjo është një tregues që bëhet fjalë për një efikasitet shumë të lartë të të hyrave vetanake dhe rrjedhimisht kjo ka rritur shumën e

mjeteve buxhetore për mbi 340,000.00€ më shumë të cilat barten në investime nga të hyrat vetanake të Komunës së Podujevës.

Po ashtu u cekë edhe çështja e mos specifikimit të projekteve të cilat figurojnë në dokumentacionin përkatës, mirëpo vlen të ceket se të gjitha projektet për të cilat barten këto mjete buxhetore janë projekte të miratuara në buxhetin e vitit 2021 (të njëjtat kode dhe të njëjtat projekte) e që këtë buxhet e ka hartuar LDK në vitin 2020 dhe që këtu pajtohem për paaftësi.

Sa i përket çështjes që u cek se po kryhen detyrimet e fushatës, sërish po e them se bëhet fjalë për projekte të vitit 2021 të cilat për arsye të ndryshme të ecurive të realizimit të punëve nuk janë realizuar ndoshta në kohën e paraparë dhe rrjedhimisht këto projekte duhet të përfundohen në këtë vit që jemi dhe për të njëjtat të ekzekutohen pagesat e që në rast se ato punë do të kishin përfunduar me kohë do të kryheshin edhe pagesat me kohë, prandaj nuk janë kryer punët për çështje të fushatës ashtu siç u tha por pritet të kryhen sivjet dhe të bëhen pagesat me këtë bartje buxhetore në mënyrë që të përfundojnë procedurat edhe në aspektin buxhetor.

z.Gazmend Islami, theksoi, drejtori parafolës ka filluar të na mbaj ligjërata, por unë nuk po qëlloj gjithherë këtu prezent, mirëpo jua them se po të ishte ndonjë subjekt tjetër duke qeverisur dhe po t'i mbetej buxhet sigurisht se nuk do të mund të rrinte në sallë fare prej juve dhe pikërisht prej teje drejtor sepse do të bëje zhurmë të madhe duke kritikuar për mos dije të menaxhimit të buxhetit. Pra është mirë të specifikohen gjërat sepse vërtetë unë nuk pash asgjë diçka specifike, ku bartet shuma e mbetur buxhetore dhe për çfarë arsye, mirëpo tani e hidhni fajin tek LDK-ja duke thënë se nuk kanë ditur t'i bëjnë projektet mirë. Ajo që po dua ta them është se ky diskurs politik i juaji është paksa i ligë, por për të pasë bashkëpunim të mirë për çështjet madhore të Komunës duhet të jemi konstruktiv, dhe s'pari duhet të jemi të formuar si njerëz për çka jemi këtu, pra inatet politike për çështje madhore humbin dhe si të tilla duhet të zhduken. Çdo diskurs politik bëhet për inate duke cekë emra të subjekteve (LDK, PDK, AAK etj) mirëpo ne të gjithë jemi në dijeni se ku kemi qenë dhe si është qeverisur, jo vetëm këtu por në gjithë Kosovën, mjafton ta shikojmë tani magjistralen Podujevë - Prishtinë se si është bërë dhe si është premtuar duke gënjyer nëpër fushata se për dy javë do të kryhet ai segment ky segment, ndërsa në realitet asnjë lopatë asfalt nuk është hedh, andaj mendoj se model i keq është e jo i mirë, prandaj do të doja të paktën prej juve (i drejtohet drejtorit të DBF) të jeni shumë më konstruktiv qoftë edhe me opozitën sepse jeni në politikë moti andaj për të pasur bashkëpunim me opozitën duhet sinqeritet mes vete.

znj.Adelinë Stublla, kërkoj një pauzë të shkurtër.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me shumicën e të pranishmëve u përkrahë propozimi për një pauzë 10 minuta.

Kuvendi shkon në pauzë në ora 10:55

Pas pauzës mbledhja vazhdon duke filluar në ora 11:10

Kryesuesi i Kuvendit, pasi konstatoi kuorumin, ku në sallë prezent fillimisht janë 30 anëtar/e të Kuvendit, kurse në vazhdim marrin pjesë edhe të tjerët, përkatësisht 34 anëtar/e të Kuvendit, dhe vazhdoi, pra jemi në pikën e rendit të ditës për propozim vendimin për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2021 në vitin 2022 dhe destinimin në kategori dhe programe të caktuara buxhetore, andaj meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, e hedh në votim propozim vendimin përkatës sipas materialit të dërguar për këtë pikë si dhe propozimet për plotësim ndryshim të disa shumave të paraqitura nga drejtori i DBF-së në fjalën hyrëse.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 34 anëtar/e të Kuvendit të Komunës sa ishin prezent në sallë, me 17 vota PËR, 1 votë KUNDËR dhe 16 vota të PËRMBAJTURA, miratohet propozim vendimi sipas materialit përkatës të dërguar në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës dhe propozimeve shitesë të prezantuara për korrigjim të disa shumave nga drejtori i DBF në fjalën hyrëse, përkatësisht zvogëlimin për 1.25€ / rregullimin e shumave në programet përkatëse në raport me shumën totale të bartjes me atë që figuron në propozim vendimin e dërguar si dhe në nenin 1 të ceket shuma e inkasuar e mjeteve buxhetore që tejkalon shumën e mjeteve të planifikuara nga të hyrat vetanake për vitin 2021.

4. Propozim Rregullorja për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve - Raporti nga diskutimi publik

Kryesuesi i Kuvendit, i njoftoj duke i'u rikujtuar anëtarëve të Kuvendit se kjo draft rregullore ka qenë për diskutim fillestar në këtë Kuvend dhe i është dhënë miratimi për vënien në diskutim publik. Diskutimi publik është mbajtur dhe është përgatitur raporti përkatës i cili i'u është dërguar së bashku me draftin final të gjithë anëtarëve të Kuvendit, dhe fton për fjalë hyrëse përfaqësuesin nga Ekzekutivi i Komunës.

z.Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, Komuna e ka një Rregullore për ndarjen e subvencioneve e cila daton nga viti 2012 dhe është konsideruar se ka nevojë për ndryshim dhe plotësim, përkatësisht Komuna ka nevojë për një Rregullore të re në mënyrë që t'i përgjigjet edhe zhvillimeve që kanë ndodh përgjatë këtyre viteve si dhe të siguroj një transparencë dhe një ndarje më të drejtë të subvencioneve.

Me këtë draft rregullore përcaktohen kushtet, kriteret dhe procedurat që do t'i mundësojnë Komunës së Podujevës ndarjen e mjeteve financiare pa kthim nga kategoria e subvencioneve nëpër fushat përkatëse të cekura në këtë draft për perona fizik dhe juridik si dhe vendosjen e një sistemi transparent dhe llogaridhënës në financimin e projekteve, aktiviteteve dhe dhënies së ndihmave për nevoja të ndryshme të qytetarëve, ku përfshihen subvencionet në fushat arsim, zhvillimit ekonomik, bujqësie pylltarisë dhe zhvillimit rural, shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, kulturës rinisë dhe sportit etj.

Qëllimi i draftimit të një rregulloreje të re është për arsye se kemi konsideruar se nevojiten disa ndryshime që ta sigurojmë transparencën dhe ndarjen e drejtë të subvencioneve e që edhe nga diskutimet publike kemi arritur që ta finalizojmë këtë dokument që ju është dërguar dhe që besoj se i plotëson këto kritere të jetë një rregullore për ndarjen e subvencioneve.

z.Gazmend Islami, theksoi, ta marrim shembull përse është nisë mbrapsht tek ndarja e subvencioneve siç është sporti, meqë parafolësi vie nga fusha përkatëse, përkatësisht vërejta shumat e përfitimeve të klubeve sportive ku kemi klube të cilat janë përfituese të shumave marramendëse dhe kemi klube tjera të cilat janë përfituese të shumave që janë për keqardhje, shembull, Klubi i Volejbollit të femrave që është një krenari për Llapin dhe e cila ka hyrë në super ligen e Kosovës ju kanë ndarë subvencione në shumë 800.00€, kurse një X klubit shkollë e futbollit i janë ndarë shuma 3000.00€ përkundër që fëmijët në atë shkollë duhet të paguajnë nga 30 € dhe janë të paktën 250 fëmijë që janë pjesë e atij klubi, andaj çfarë logjike ka ai drejtor që i ndan 800.00€ një Klubi që ka hyrë në super ligë siç është Klubi i volejbollit për femra, kurse Klubit të Basketbollit që garon në ligat më të dobëta i ndahen 3000.00€, e që unë mendoj se është logjikë e mbrapsht. Unë nuk jam që të mos ndihmohen të gjitha klubet në këtë rast, mirëpo mendoj se ata që janë më të suksesshëm

duhet të mbështeten më shumë dhe kur e them këtë jam në dijeni se ai Klub shembull me ato 800.00€ duhet të shkojë të zhvilloj lojë në Pejë, Gjakovë etj ta zëmë, andaj nuk e di me çfarë logjike është bërë ajo ndihmë prej 800.00€ e që unë e quaj më shumë humor dhe ndoshta më mirë do të ishte të mos ndihmohej fare dhe t'i thuhej nuk po kam dëshirë të të ndihmoj, nëse i ke ndarë ato mjete sipas “dostave dhe shokëve” që i ke atëherë në rregull.

znj.Arjeta Abazi, në emër të këshilltarëve të LDK-së, theksoi, propozim rregullorja për kriteret kushtet dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve do të ishte hapë i duhur nëse vërtetë do ta kishte për qëllim orientimin e drejtë të ndarjes së subvencioneve duke siguruar dhe promovuar meritokracinë dhe shanset e barabarta gjatë zbatimit të saj. Kjo rregullore mbulon shumë sektorë të rëndësishëm, por si fillim duhet të ndalemi te pjesa e subvencionimit të studentëve dhe nxënësve përmes bursës çështje për të cilën edhe te votimi i buxhetit kam kërkuar rritje të buxhetit për këtë fushë, edhe pse vitin që shkoj si pasoj të ndryshimit të kriterëve janë prodhuar shumë probleme dhe shumë nxënës meritator kanë mbetur pa përfutur bursë, andaj kjo çështje sërish nuk është definuar siç duhet sepse bursa në esencën e saj ka mbështetjen e nxënësve elitar, ata me sukses shembullor, andaj tendenca që në këtë sistem të futen edhe kategori të tjera të cilat për mua janë shumë të nderuara, por e dëmton procesin dhe për këtë kemi si model vitin e kaluar. Nëse vërtetë dëshironi t'i ndihmoni nxënësit e familjeve në nevojë gjeni forma tjera duke shpallur ekstra thirrje përmes donatorëve dhe cila do qoftë mundësia, përkrahjen tonë si Grup i LDK-ës do ta keni gjithmonë, por jo në këtë formë sepse kështu po i humbet koncepti i bursës.

Te fusha e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale mendoj që sidomos te rastet e mbështetjes për at siguruar terapinë e barnave duhet të mundësohet dy apo tre herë brenda vitit, edhe ashtu shuma e mjeteve që ndahet rëndom është e vogël kurse çmimet e barnave sa vijnë e rriten.

Te fusha e bujqësisë kemi përkrahjen e Shoqatave, si është e mundur të nxirret rregullore për subvencione në bujqësi që rregullon përkrahjen e Shoqatave kur dihet se ekziston Rregullorja MF nr.04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve në nivel qendrorë dhe lokal, si mund të jetë kjo rregullore mbi rregullore kur dihet se Shoqatat regjistrohen njëjtë si Organizata Joqeveritare. Pastaj në një rast hasa në termin, përkrahje e kooperativave bujqësore, mirëpo nuk e di nëse ka kooperativa të tilla funksionale në Komunën tonë. Mandej te dëmet në bujqësi duhet të specifikohen në mënyrë më të detajuar dhe të dihen se ku mund të merren mjetet për kompensim. Një vërejtje tjetër tek dokumentet e kërkuara për aplikim për fermerët ku kemi mbingarkesë sa i përket dokumentacionit, si ka mundësi që t'ju kërkohej fermerëve për një subvencion gjithë ato dokumente kur kjo është një formë stimulimi dhe mjetet janë të hyra vetanake të Komunës, nuk është buxhet i ndarë nga Qeveria, nuk janë grante për investime fizike që t'ju kërkohej gjithë ato dokumente, andaj kjo burokraci që tenton të praktikohet është e panevojshme dhe është ngarkesë shtesë për një subvencion edhe ashtu të vogël.

Te fusha e zhvillimit ekonomik, përparësitë tek ndarjet e subvencioneve, pika 2, Bizneset e përcaktuara të paragrafit 1.3 dhe 1.4 mund të aplikojnë edhe jashtë kohës së aplikimit, kjo bie ndesh me çdo rregullore për kriteret dhe subvencione dhe mund të jetë edhe konflikt interesi sepse i mundëson drejtorit ose komisionit ta favorizoj cilindo biznes që dëshiron, andaj kjo pjesë mendoj se duhet të hiqet. Neni 6 pika 2, personi fizik dhe juridik vetëm një herë mund të jetë përfutur i subvencioneve gjatë vitit kalendarik, bujqësia është sektorë që ngërthen në vete shumë fusha dhe nuk mundet asnjë rregullore t'ia ndaloj të drejtën e aplikimit në fusha të ndryshme fermerit, komisioni mund ta vlerësoj me pikë më pak nëse është përfutur i ndonjë projekti, por asesi ta diskualifikoj.

Po ashtu edhe tek mbështetja për OJQ-të, sidomos në kulturë rini dhe sport, mendoj se nuk duhet të favorizohen ata që nuk kanë përfutur më parë, por sigurisht ata të nxiten për të aplikuar mirëpo

duhet të shikohet realizueshmëria emirë e projektit dhe impakti në shoqëri dhe ky të jetë kriter i mbështetjes.

Për fund, siguroj që vërejtjet dhe sugjerimet tona qëllim të vetëm e kanë funksionimin sa më të mirë të rregullores dhe t'iu lehtësohen procedurat personave dhe grupeve të targetuara.

z.Ragip Fetahu, theksoi, kultura e debatit dhe shprehja e mendimit të mirë është pjesë e pashmangshme në një demokraci të lirë, me këtë dua të them se propozim rregullorja për të cilën ne sot po flasim ka qenë në diskutim publik dhe ka qenë periudha e caktuar në të cilën secili nga ne ka pasë mundësi me shpreh mendimin e tij përmes formës elektronike por edhe tek vet drejtori përkatës, prandaj është shumë e rëndësishme që ne të krijojmë një kulturë të tillë që mendimet tona dhe idetë tona të mos i bëjmë si në të kaluarën siç ka qenë vetëm në formë verbale, por ato t'i dërgojmë në momentin e duhur, në kohën e duhur dhe në adresën e caktuar në mënyrë të shkruar.

z.Demokrat Hodolli, theksoi, unë e kam një vërejtje, sugjerim apo këshillë, të merret kjo qysh dush, dhe ka të bëjë me subvencionet, dhe atë, subvencionet që janë ndarë në bazë të listës datë 08.04.2022, për habinë apo për çudinë time e sigurisht për preferencën tuaj, në bazë të të gjitha akteve normative në fuqi, përfshirë edhe rregulloren për ndarjen e subvencioneve është përcaktuar decidivisht që nuk mund të jetë përfitues i subvencioneve të Komunës tonë një banorë i Komunën tjetër, kurse në listën e cekur të publikuar, figuron emër mbiemër me nr. rendor 63 dhe vendbanimin e ka Prishtinë, andaj pyes a është kjo qeverisja juaj krejt dhe drejtë.

znj.Qëndresë Hajrizi, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-ës e përkrahim dhe e mbështesim këtë pikë të rendit të ditës.

z.Gazmend Islami, theksoi, tek Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural sa kam mund ta vërejë e shoh se ka një përmirësim ngase ndarjet e mëhershme të subvencioneve nuk kanë qenë bash të drejta dhe ka pasë çdo herë njerëz të privilegjuar dhe ka raste që kanë marrë subvencione nga 10 herë në vit ndoshta e që për mua nuk është në rregull, andaj kriteri përkatës i vendosur për këtë çështje unë e shoh se është i drejtë dhe për këtë arsye unë e mbështesë këtë propozim rregullorë.

z.Fatmir Rudari, U.D. drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-DBPZHR, theksoi, lidhur me shqetësimin e këshilltarit parafolës z.Demokrat Hodolli është e vërtetë se në listën e fundit të publikuar është bërë një lëshim që ka të bëjë me subvencionimin me Bletë, mirëpo pasi është vërejtur ai lëshim nga ana e Komisionit përkatës e kanë kontaktuar personin në fjalë dhe tani është në proces të zëvendësimit të atij personi.

z.Pajtim Balaj, U.D. drejtor i Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit-DKRS, theksoi, edhe pse ishte jashtë rendit të ditës, përkatësisht jashtë rendit të ditës për të cilën po diskutojmë e që ka mund lihet në fund të seancës për diskutim në pikën Të ndryshme, por pavarësisht kësaj unë po e marr mundin të përgjigjem në deklaratimet e këshilltarit z.Gazmend Islami.

E para dhe që është më e rëndësishmja, asnjë vit më herët në Komunën e Podujevës Klubet sportive nuk kanë marrë mbështetje më të madhe financiare, është afër 30,000.00€, është viti i parë që Klubet sportive të Komunës së Podujevës mbështeten me një shumë kaq të madhe.

Ndër pikat që janë bazuar Komisioni për t'i ndarë këto subvencione është popullariteti i sporteve, 1000.00€ për sportin më popullor në Komunën tonë, shtetin tonë dhe kontinentin ku ne jetojmë vërtetë janë shumë pak. Mund t'i pyesni Klubet sportive që garojnë në futboll, a janë mjaftueshëm 100 €, edhe nëse i marrin disa mjete buxhetore me të cilat i nxjerrin disa rroga nuk mendoj se bëjnë keq, fundja po kontribuojnë për ta zhvilluar një sport me të cilin ne po krenohemi për çdo ditë, çoftë me performancën e përfaqësueses së Kosovës qoftë me djemtë tanë që luajnë në përfaqësuese tjera.

Pastaj sukseset e viteve paraprake kanë qenë një përcaktues i rëndësishëm dhe ato Klube të cilat kanë pasë suksese të mëdha në vitet e kaluara por që padrejtësisht ndonjëherë janë diskriminuar për çfarëdo arsye që mund të kenë qenë në të kaluarën është përprjekur që të kompensohen për dëmet që

janë bërë viteve të kaluara ndaj tyre dhe për këtë nëse dëshironi mund t'i përmendim të gjitha dhe jemi në dijeni për sukseset që i kanë pasë, por që janë shpërfillë.

Ka pasë edhe ndihma të nivelit qendrorë siç është rasti i njërit prej Klubeve që ka marrë afër 5000€ prej Ministrisë dhe nuk ka qenë e arsyeshme që t'ia japim edhe ne 5000€. Ka pasë mjaftueshëm Klube të tilla dhe varësisht prej performancave që i kanë këtë vite do t'i vlerësojmë edhe në vitet e ardhshme dhe sigurisht se edhe Klubi i volejbollit dhe gjitha të tjerat do të mbështeten proporcionalisht me sukseset që kanë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, meqë po diskutohet paksa jashtë temës, unë e kam një pyetje për drejtorin parafolës i cili e potencoj se janë shpërfillë, e pyes atë sepse kjo drejtori që ky e udhëheqë “nuk ka dalë prej shtëpisë së tij” që 23 vite, andaj kush ka shpërfillë, përse nuk e keni pyetur babin t'uaj në shtëpi sepse edhe ai ka qenë drejtor nëse veç ka shpërfillje ashtu siç e cekët.

z.Gazmend Islami, theksoi, nuk është mirë të personalizohen këto gjëra, mirëpo unë mendoj se është diskriminim nëse mendojmë, shembull të favorizojmë një X Klub të futbollit, mandej ta marrim Volejbollin për të cilin duhet të jemi krenar që ka arritur t'i ketë në Klub së paku 100 femra/vajza të reja dhe të shkëlqyera të cilat kanë arritur të hyjnë në Super ligen e Kosovës dhe kjo është punë e madhe, prandaj unë nuk e thash se nuk janë bërë ndarja e mjeteve por e thash se nuk janë ndarë dhe nuk i është dhënë meritë atij Klubi ashtu siç e meriton, pra 800€ mbështetje për një Klub i cili ka kaluar prej ligës së parë në Super ligë dhe duke pasë parasysh edhe faktin se kemi vajza Llapjane të cilat tani luajnë për Kombëtaren e Kosovës për çka jam shumë krenar dhe që i'u kam ndihmuar aq sa kam mundur si Gazmend, mirëpo tani gjërat duhet të merren logjikshëm dhe ai Komision që ka qenë mendoj se nuk është profesional dhe nuk mund të vlerësohet si i tillë kur diskutojmë për një Klub i cili hyn në Super ligë me punën e madhe që e ka bërë.

pra dua të them që mos të favorizohen vetëm Klubet e futbollit sepse kemi edhe faktin se në Komunën e Podujevës kemi rreth 10 shkolla të futbollit në të cilat fëmijët paguajnë nga 30€ në muaj, kurse Komuna sërish ndan mjete nga rreth 3000€, andaj e them se nuk është në rregull kjo çështje dhe është në disproporcion kjo.

z.Naim Çunaku, theksoi, meqë veç u deviju kjo nga rendi i ditës, jam shumë i interesuar të di çka është me Shkollën e Kitarës “Mirela”, a mendoni se kjo shkollë e paraqet një imazh të mirë për Komunën tonë dhe përse nuk është ndarë asgjë nga subvencionet për këtë Shkollë.

z.Ragip Fetahu, kërkoi nga Kryesuesi që të vazhdohet me rendin e ditës sipas kësaj pike, duke e cekë se po diskutohet jashtë rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit, përgjigje parafolësit, konsideroj se nuk dolëm jashtë rendit të ditës ngase po diskutohet për subvencione edhe pse në rend të ditës kemi propozim Rregulloren për ndarjen e subvencioneve.

z.Pajtim Balaj, U.D. drejtor i DKRS, theksoi, fillimisht nuk e di a e keni lexuar propozim rregulloren për të cilën po diskutojmë, e them këtë sepse kjo rregullore rregullon punën se si do të ndahen subvencionet në të ardhmen, por jo për subvencionet që janë ndarë sepse këto janë në diskrecionin e Komisioneve që themelohen nga Kryetari i Komunës e jo të Drejtorive.

Sa i përket bابت tim që u cek, unë këtu përfaqësoj Shpejtim Bulliqin dhe Lëvizjen Vetëvendosje, jam i emëruar nga Shpejtim Bulliqi dhe kur unë e kam nisë aktivitetin tim politik Agim Velu ka qenë Kryetar i Komunës dhe bابت im ka qenë drejtor i Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit-DKRS, dhe ju siguroj se unë kam qenë kritikë më i madh i asaj qeverisje se sa ju.

Në lidhje me buxhetin, unë e di se buxheti ka qenë shumë më i varfër në të kaluarën mirëpo në vitet e fundit buxheti i DKRS ka qenë i madh, mundësitë për sport kanë qenë të mëdha mirëpo kjo nuk ka ndodhur, kurse përpjekjet me i fitu debatet, secili prej nesh kemi familjarë dhe kemi ndonjë lidhje

ndokund, andaj kjo është hera e fundit që marrë mundin të përgjigjem në sulme të tilla që në thelb janë shpërfaqje e pamundësisë më të ndërtuar prej një Grupi të tërë parlamentar.

Sa i përket Shkollës së Kitarës “Mirela” është thirrja publike për mbështetje të projekteve kulturore dhe ka kohë deri më 4 maj 2022 dhe besoj se ajo Shkollë do të aplikoj dhe në kuadër të mundësve tona buxhetore ju siguroj se do të mbështetet, edhe pse sa ka nevojë Shkolla “Mirela” ne nuk kemi buxhet sepse puna që bënë ajo kërkon mbështetje shumë më të madhe, por shpresoj se në të ardhmen do të kemi mundësi të themelojmë një ansambël dhe Shkolla “Mirela” dhe që puna që bëhet në të prej profesorit z. Imer Musa të jetë pjesa qendrore mbi të cilën ndërtohet aktiviteti kulturor-arstistik.

z.Naim Çunaku, theksoi, e vërtetë që debati doli jashtë rendit të ditës, përgjigjja e drejtorit parafolës zotëri Balaj dhe konstatimi i tij që një Grup i tërë nuk mund të artikuloj, për këtë duhet ta tërheq fjalën ai, përndryshe nuk mundet askush e as ai që një Grup të tërë të këshilltarëve të një subjekti politik ta cilësoj në këtë formë. Nëse nuk tërheq fjala ose nuk kërkon fjalën ne detyrohemi të veprojmë në formën tonë demokratike, përndryshe me atë që e potencoj i ka tejkaluar të gjitha masat e një dialogu parlamentar.

z.Pajtim Balaj, U.D. drejtor i DKRS, theksoi, unë vetëm po kërkoj argumente, nuk i bëra fyerje askujt.

z.Naim Çunaku, përgjigje drejtorit parafolës, theksoi, konstatimi Juaj përkatës për një Grup të tërë parlamentar, ose duhet të distancoheni ose nuk mund të vazhdojmë kështu sepse nuk mund ta fyesh një Grup të tërë parlamentar dhe nuk mund t’i fyesh rreth 17000 vota të qytetarëve të Komunës së Podujevës. Sa i përket fyerjes, unë konsideroj se po ta konsideronit ju fyerje nuk do ta thoni atë, por unë e konsideroj fyerje.

z.Pajtim Balaj, U.D. drejtor i DKRS, unë nuk e konsideroj si fyerje deklarin e këshilltarit të Grupit të LDK-së për mu, por e konsideroj se nuk është argument dhe është mirë të ndërtohen argumente nga Grupi juaj parlamentar meqë po thirrreni në ato vota që i keni marrë e që unë nuk po shoh të tilla, por po shohë vetëm inate politike dhe atë në secilën pikë, nuk ka argumente, ju dëshmoni të kundërtën andaj edhe nuk përse të kërkoj falje.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuar zotëri Balaj, ne nuk bëjmë argumente që të shkojnë për shtati ty dhe që të pëlqejnë ty, ne i kemi argumentet tona që i ndërtojmë mbi platformën e subjektit politik.

Kryesuesi i Kuvendit, i kërkon parafolësit z.Naim Çunakut që për ta marrë fjalën duhet ta kërkoj e pastaj të debatoj, e jo kështu.

z.Naim Çunaku, përgjigje Kryesuesit të Kuvendit, theksoi, nëse një rregull i tillë vlen për mua si këshilltar i Kuvendit dhe për ty si Kryesues i Kuvendit, aq më shumë vlen për drejtorin, dhe të kesh kujdes sepse je duke e drejtuar seancën në atë formë që do ta çrregullosh. Unë pata vërejtje personale dhe fundja nuk toleroj fyerje nga askush.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, secili duhet të pres ta marr fjalën, për më shumë fjala ju jap secilit që e dëshiroj mirëpo nuk ka nevojë askush ta marrë fjalën përderisa është duke diskutuar dikush tjetër.

z.Naim Çunaku, përgjigje Kryesuesit të Kuvendit, fundja ti e lejoje që kjo të merr kahje jashtë rendit të ditës, i ke kontribuar kësaj.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, nuk i kontribuoj askujt mirëpo tema është për propozim rregulloren për subvencione dhe n’kuadër të kësaj u diskutua për sport, kulturë etj dhe për këtë u debatua, konkret ishte këshilltarja znj.Arjeta Abazi e cila diskutoj për propozim rregulloren, kurse të tjerët dolën nga pika e rendit të ditës, konkretisht ishte propozim i të përmendurës për heqjen e një pike (pika 6 sa mbaj mend) nga kjo propozim rregullore, çështje tjera konkrete nuk pati, prandaj është rregull që pas diskutimeve përfundimtare dhe propozimeve, sugjerimeve dhe vërejtjeve konkrete, pastaj hedhën në votim, mirëpo nuk mundemi që të diskutojmë vetëm sipërfaqësisht për një dokument si përgjithësisht.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit nuk mund shkoj kështu siç thua, nëse ti i jep veti të drejtë të gjykosh si dhe çka duhet të diskutoj znj.Arjeta Abazi e ke gabim, ti nuk je spozorues i propozim rregullores dhe për këtë fol ai që e ka propozuar, jo ti.

Kryesuesi i Kuvendit, përgjigje parafolësit, theksoi, unë jam ai që i hedh në votim propozimet sikurse që ishte ai i këshilltares znj.Arjeta Abazi, e jo drejtori, andaj të mos ngutemi me deklarime.

znj.Arjeta Abazi, theksoi, për krejt atë e potencova dhe që kërkova më parë nuk do të duhej të kishte një fyerje nga ana e drejtorit të DKRS-së pikërisht për atë që e potencoj “vetëm kërkesa”.

z.Artrit Mulliqi, theksoi, në qoftë se Grupi i këshilltarëve të LDK-së e konsideron fyerje deklaratën e drejtorit z.Pajtim Balaj, atëherë çfarë e konsideroni deklaratën e këshilltarit t’juaj.

Unë mendoj se përfshirja e emrave të familjarëve në këtë seancë është më fyerje se sa që deklaroj drejtori i DKRS-së.

z.Naim Çunaku, theksoi, nëse zotëria në fjalë këshilltar nga radhët e Grupit të LDK-së pati një çështje personale që ishte me emër të tij, ndërsa drejtori i DKRS e zuri në gojë gjithë Grupin e LDK-së. Drejtori edhe mund ta praktikoj dhe të cilësoj ndokënd me emra personal, mirëpo ta cilësoj një Grup të tërë që nuk është në gjendje të artikuloj një qëndrim, atë mund ta bëjë dhe mund të vazhdoj, por në rend të parë si Kryesues i Kuvendit duhet të distancohesh nga ajo e që mendoj se do të ishte e udhës të distancohej edhe Kryetari sepse drejtori është nën kompetencë të tij, të intervenohet dhe të kërkohet falje për atë lëshim, nëse është lëshim, por nëse është qëllim ta vazhdoj atë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, kur e ceka babin e drejtorit se ka qenë drejtor më parë, unë nuk e kam zgjedh andaj nuk është diçka ajo që të thuhet pastaj ma përmende babin. Drejtori i DKRS-ës e tha se në të kaluarën nuk janë subvencionuar, dhe unë i thash se për këtë është dashtë ta pyes babin e tij sepse ka qenë drejtor i DKRS-së më parë, dhe që e kanë “uzurpuar” këtë drejtori që 22 vite, kurse drejtori i DKRS-ës e tha se nuk kam qenë me të në aspektin politik, mirëpo unë mendoj se ka me të sepse me kitarë me çka ka pasë i keni vjedhë i keni qu te shtëpia, kurse tani del dhe na tregon neve jo s’kemi qenë jo kemi qenë, jo Grupi i këshilltarëve jo andej jo kënde.

z.Bashkim Sylja, theksoi, lus Kryesuesin e Kuvendit që këto debate të mos i lejosh të zhvillohen më tutje, si dhe ta zbatosh në përpikëri Rregulloren e punës së Kuvendit dhe të mos lejohet ta merr ndokush fjalën më shumë se sa është e përcaktuar. Urdhëroni fokusoni në rend të ditës, përndryshe ta hedhni propozim rregulloren në votim sepse nuk na kanë hije debate të tilla. Fyerje pati prej dy anëve, qoftë nga drejtori i DKRS-së qoftë nga këshilltari parafolës, andaj të mos shkohet tutje me debate të tilla.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, për fjalë të drejtorëve nuk mbaj përgjegjësi unë si Kryesues i Kuvendit por mbajnë secili prej tyre për fjalën e vet, kështu që nëse ndokush është ndier i prekur, fjalën i’a jap edhe njëherë drejtorit të DKRS.

z.Pajtim Balaj, U.D. drejtor i DKRS, theksoi, sërish e them se unë e konsideroj se nuk e kam fyer askënd, por nëse ndokush është ndier i fyer kërkoj falje, por nuk besoj se është fyerje, ndërsa a mendoj se nuk po ndërtohen argumentet vazhdoj të mendoj ashtu.

Kurse sa i përket akuzës për vjedhje, tani rreth 1 vit më parë më është bërë një e njëjtë dhe për atë jam adresuar me padi dhe do të vazhdoj njëjtë sërish, kurse këshilltarit Ekrem Rrahmani i mbetet ta dëshmoj në gjykatë se çfarë kam vjedh unë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, meqë debati për propozim rregulloren sipas kësaj pike të rendit të ditës përfundoj dhe nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, atëherë unë e hedh në votim.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 34 anëtar/e të Kuvendit të Komunës sa ishin prezent në sallë, me 21 vota PËR, asnjë votë KUNDËR dhe asnjë votë të PËRMBAJTUR, miratohet propozim Rregullorja sipas materialit përkatës të dërguar në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës.

znj.Arjeta Abazi, theksoi, i nderuar Kryesues, unë e pata një propozim dhe lexova në diskutimin tim, andaj të hedhet në votim.

Kryesuesi i Kuvendit, kërkoj nga parafolësja që ta lexoj edhe njëherë konkretisht propozimin, ose ta dorëzoj me shkrim.

znj.Arjeta Abazi, përgjigje Kryesuesit të Kuvendit, theksoi, nëse duhet të përsëriten propozimet edhe njëherë atëherë po e fillojmë seancën edhe njëherë prej fillimi dhe po i përsërisim të gjitha.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, unë nuk mund t'i mbaj të gjitha shënimet për secilin propozim, andaj meqë proceduralit u votua njëherë për këtë propozim rregullore, e konsideroj të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës dhe vazhdojmë me pikën e radhës.

5. Propozim Rregullorja për funksionimin e institucioneve edukative-arsimore të Komunës së Podujevës **- Raporti nga diskutimi publik**

z.Avni Fetahu, U.D. drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, para vetës e keni propozim rregulloren për funksionimin e institucioneve edukative-arsimore në Komunës së Podujevës, dhe gjithashtu keni të bashkëngjitur një raport i cili përmban sugjerimet, vërejtjet dhe plotësimet për propozim rregulloren në fjalë.

Unë nuk dëshiroj të zgjati shumë për arsye se draftin e rregullores keni të gjithë, dhe ju falënderoj për pjesëmarrjen në diskutimin publik që është mbajtur më 15 mars të muajit të kaluar ku kanë marrë pjesë drejtor të institucioneve edukative arsimore por edhe qytetarë. Gjithashtu i jam falënderues edhe secilit këshilltarë të Kuvendit që përmes formës zyrtare elektronike (përmes e-maileve) kanë dhënë sugjerimet e tyre e që ne i kemi inkorporuar në draftin e rregullores në fjalë por edhe ato që nuk kemi pas mundësi t'i fusim në këtë rregullore e që bëhet fjalë për pagesën e kujdestarisë e cila parashihet me Udhëzim Administrativ dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore që nga viti 2023 niveli qeveritar ta mbuloj këtë pagesë për kujdestarinë e klasave që i kanë mësimdhënësit.

Pra nga Ju kërkojmë mbështetjen për këtë propozim rregullore e cila nuk do të na lehtëson punën vetëm neve si Drejtori e Arsimit, mirëpo do ta vëreni edhe ju si prindër së bashku me fëmijët e juaj do t'i dini qartë detyrat dhe përgjegjësitë që i kanë edhe drejtorët e shkollave, edhe mësimdhënësit por edhe nxënësit në shkolla.

z.Qëndrim Softolli, në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së, theksoi, si grup i këshilltarëve nga radhët e LDK-së e kemi mbështetur vënien në diskutim publik të kësaj propozim rregulloreje, mirëpo në draft shihen qartë një mori shkeljesh së Ligjeve dhe Udhëzimeve Administrative bazike të fushës së arsimit si dhe është anashkaluar Kontrata Kolektive.

Këtë propozim rregullore e karakterizon tejkalimi i autorizimeve ligjore, dhe si e tillë në tërësinë e saj i ngjason një organogrami me përshkrim të detyrave të punës së personelit të shkollave, të drejtat dhe detyrimet, e që kjo ka qenë panevojshme sepse të drejtat dhe detyrimet e personelit i cakton Ligji për arsimin parauniversitar dhe një mori udhëzimesh të MASHT, Kontrata Kolektive si dhe kontrata e punës e secilit punëtor të arsimit parauniversitar.

Unë po fokusohem te Kreu V i propozim rregullores ku janë masat edukativo disiplinore, pjesë në të cilën drejtori i Drejtorisë së Arsimit është kujdesuar për nënshtrim të udhëheqjes dhe stafit të shkollave e që i njëjti 2 vite më parë si asambleist i VV-s i kritikonte, madje duke përdorur edhe epitete fyese. Në nenin 50 nga gjithsej 10 masa disiplinore 5 prej tyre nuk kanë mbështetje ligjore, pra janë të jashtëligjshme sepse rregullorja nuk mund të ketë masa disiplinore më shumë se sa që

parasheh ligji. Neni 85 i Ligjit të punës – masat disiplinore për shkeljet e detyrave të punës thuhet, për shkeljet e detyrave të punës, të punësuarit do t'i shqiptohet njëra nga këto masa ndëshkuese, - vërejtje me gojë, -vërejtje me shkrim, -ulje në pozitë, -suspendim të përkohshëm dhe -ndërprerje të marrëdhënies së punës. Pastaj në paragrafin 2 thuhet, masat -vërejtje me gojë, -vërejtje me shkrim dhe -ulje ose degradim të pozitës, do të shqiptohen për shkelje të lehta të detyrave të punës në pajtim me Kontratën Kolektive, aktin e brendshëm të punëdhënësit dhe kontratën e punës, mandej masat ndëshkuese -suspendim i përkohshëm dhe -ndërprerja e marrëdhënies së punës, do të shqiptohen për shkelje të rënda të detyrës së punës në pajtim me Kontratën Kolektive, aktin e brendshëm të punëdhënësit dhe kontratën e punës.

Me hyrjen në fuqi të ligjit për zyrtarët publik procedurat disiplinore për të gjithë të punësuarit shqiptohen siç e parasheh ky ligj, sipas të cilit ligj rregullohet marrëdhënia juridike ndërmjet shtetit dhe zyrtarëve publik, pra zyrtar publik janë: Nëpunësi i shërbimit civil, Nëpunësi i shërbimit publik që janë punëtorët e arsimit në këtë rast, Nëpunësi i kabinetit dhe Nëpunësi administrativ dhe mbështetës. Neni 47, te masat disiplinore të cilat mund të zbatohen ndaj Nëpunësit civil janë; - vërejtje, -ndalim nga 20% deri në 40% të pagës për një periudhë deri në 6 muaj, -ndalimi i ngritjes në detyrë duke përfshirë këtu edhe ngritjen e shkallës së pagës për një periudhë nga 2 deri në 5 vite, si dhe -largim nga shërbimi civil.

Neni 48, kompetenca dhe procedura disiplinore, thuhet, masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij Ligji jepen nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt, mbikëqyrësi i drejtpërdrejt detyrohet të filloj procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara mbi shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil, ndërsa masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri në 1.4 të nenit 47 të këtij Ligji janë në kompetencë të Komisionit disiplinor.

Sipas propozim rregullores në këtë pikë të rendit të ditës, masat edukativo disiplinore, në nenin 50 thuhet, masat disiplinore ndaj stafit drejtues dhe stafit mësimdhënës dhe teknik të shkollës, nën 1 për shkelje të dispozitave të kësaj rregulloreje dhe për mos zbatimin e akteve të tjera të MASHT stafi drejtues (drejtori, zëvendësdrejtori dhe sekretari), stafi mësimor profesional dhe stafi administrativ dhe punëtorët teknik e shërbyes u nënshtrohen masave administrative disiplinore, -vërejtje me gojë, -vërejtje me shkrim, -gjobë në të holla, -adresim tek organet e rendit, -ulje në pozitë, -ndërrimi i shkollës, -ndalim i gradimit deri në 5 vite, -suspendim i përkohshëm nga puna me 50% të pagës bazë prej 1 deri në 6 muaj varësisht nga shkalla e shkeljes së detyrave të punës, -suspendim i përkohshëm nga puna pa pagesë prej 1 deri në 12 muaj varësisht nga shkalla e shkeljes së detyrave të punës, ndërprerje e përhershme e marrëdhënies së punës. Pra do të thotë pikat 1.3; 1.4; 1.6; 1.8 dhe 1.9 nuk kanë bazë ligjore në bazë të Ligjit të punës, Ligjit për zyrtarët publik dhe Rregullores për disiplinë dhe ankesa të zyrtarëve publik. Po ashtu jeni thirr në ligjin për kundërvajtje i cili e rregullon krejt një materie tjetër dhe nuk ka të bëjë asgjë me arsim, madje edhe pikat në të cilat jeni thirrur janë totalisht jashtë fushës së veprimit që rregullon Ligji për kundërvajtje ku neni 1 i tij ku e specifikon qëllimin dhe fushëveprimin thotë, me këtë ligj rregullohen kushtet për caktimin e kundërvajtjeve dhe sanksioneve për kundërvajtje, palët dhe përgjegjësia për kundërvajtje dhe proceduar e kundërvajtjes, kurse te neni 2 Nocioni i kundërvajtjes thuhet, Kundërvajtje është sjellja me të cilën shkelet ose rrezikohet rendi dhe qetësia publike, pra po duhet me i cekë edhe çka përmban Ligji për kundërvajtje.

Te pika 1.3, gjoba në të holla, ndalesë në pagë, është e rregulluar me Ligjin për zyrtarët publik në nenin 47. Pika 1.2, ndalimi nga 20% deri në 40% e pagesës për një periudhë deri në 6 muaj, rrjedhimisht kjo pikë është dashtë të jetë në harmoni të plotë sikurse që është në ligj. Pika 1.4, adresim tek organet e rendit, totalisht qesharake, e jashtëligjshme dhe fyese për fushën e arsimit.

Pika 1.9, ndërrimi i shkollës, kjo masë disiplinore duhet të jetë shumë më specifike dhe të paktën është dashtë të sqarohen se a do të përdoren nenet 52 dhe 53 i Ligjit për zyrtarët publik dhe të ishte në harmoni të plotë me Rregulloren për transferin e nëpunësve publik, të sqarohet edhe perioda e ndërrimit të shkollës, andaj kështu siç është kjo pikë e përgjithësuar nuk është në harmoni me Ligjin dhe rregulloren përkatëse.

Ne si LDK kërkojmë që para se të miratohet një rregullore e tillë, të merret mendimi ligjor i Ministrisë së linjës sepse kjo propozim rregullore bie ndesh me ligjet që rregullojnë marrëdhënien e punës në arsim, gjegjësisht masat disiplinore ndaj personelit arsimor janë të jashtëligjshme.

Mos na vëni në lajthitje neve si asamble komunale kinse po bëjmë rregullore, e që janë të jashtëligjshme ashtu siç ndodhi vitin e kaluar me rregulloren për të drejtat e fëmijëve.

Ne si Grup i këshilltarëve të LDK-së kërkojmë që propozim rregullorja për funksionimin e institucioneve edukative-arsimore të tërhiqet dhe të ndryshohen masat disiplinore sepse masat duhet të jenë në përputhje të plotë me Ligjin për zyrtarët publik dhe rregulloren për zyrtarët publik, e jo të futen masa që nuk parashihen me ligj dhe rregullore për masat disiplinore dhe ankesat e zyrtarëve publik si dhe Ligjin e punës.

Pas plotësim ndryshimit të merret mendimi ligjor i Ministrisë së linjës dhe atëherë dhe në atë formë do ta kishte edhe mbështetjen tonë.

z.Ragip Fetahu, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, theksoi, propozim rregullorja e cila është para neve, është si praktik që ka filluar më herët të zbatohet në Komunitet e Gjakovës dhe Rahovecit, pra është rregullore shumë e ngjashme dhe këtë mund ta gjejmë edhe në internet me pak mund dhe pak përkushtim. Kjo rregullore është e domosdoshme për Komunitetin tonë sepse janë disa mangësi ligjore e që në Komunitetin tonë kanë lënë shprazëti të madhe në sistemin edukativ arsimor.

Sa i përket çështjeve ligjore është mirë që ne vërtetë kemi filluar t'i lexojmë Ligjet nacionale dhe rregulloret por e rëndësishme është se kjo rregullore ka kaluar në praktikën tjetra dhe fazat tjera të cilat janë të domosdoshme për të kaluar dhe MAPL ka dhënë mendimin e vetë për këtë çështje dhe si e tillë kjo rregullore nuk paraqet asnjë shkelje ligjore por vetëm është e bazuar në rregullativën e përgjithshme ligjore, prandaj ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së e përkrahim.

z.Bashkim Sylja, në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK-së, theksoi, çdo vendim i Kuvendit komunal shkon në MAPL për vlerësim e cila pastaj i kthen vlerësimet, edhe pse deri tani disa vendime kanë shkuar në mënyrë të heshtur mirëpo tani për çdo vendim MAPL do të jep mendimin e vetë rreth ligjshmërisë, kështu që edhe kjo rregullore nëse ka ndonjë shkelje ligjore sigurisht se do të kthehet nga MAPL. Ndërsa duke parë gjendjen në arsim, unë mendoj se kjo rregullore duhet të kalojë dhe të hyjë në funksion sa më shpejt të jetë e mundur.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, vetëm deshta të ndërlihem paksa me kolegun parafolës z.Bashkim Sylja rreth kthimit të rregulloreve nga niveli qendror ku veç sot kemi tri të tilla, e që dua të them se kjo praktikë nuk po na mëson neve si duket por rregullisht po vazhdojmë të nxjerrim rregullore që mund të kenë shkelje të ligjit, andaj mu për këtë i ceka secilin nën ku ka shkelje në mënyrë që t'i paraprinë asaj.

z.Bashkim Sylja, duke i'u përgjigjur parafolësit, theksoi, ka të drejt plotësisht parafolësi z.Qëndrim Softolli dhe ne jemi në dijeni se 2 prej tyre që i kemi sot në rishqyrtim, me theks njëra që ka të bëjë me vendimin për shpërndarjen e druve të konfiskuara e që sigurisht se kolegu e dinë se si ka funksionuar në të kaluarën, qëllimi ka qenë i mirë mirëpo MAPL e ka kthyer duke e parë të arsyeshme se është në kundërshtim me Ligjin e që tani sa jam në dijeni unë ato dru kanë dalë në tenderim/ankand dhe janë në fazën e shitjes së tyre ashtu siç ka rekomanduar Ministria.

z.Qëndrim Softolli, përgjigje parafolësit, theksoi, me gjithë respektin për kolegun parafolës, mirëpo nuk vlerësohet njeti/qëllimi jonë e që sigurisht ka qenë i mirë, por vlerësohet ligjshmëria se a ka shkelje apo jo.

z.Bashkim Syla, sërish përgjigje parafolësit, theksoi, unë jam në dijeni se shumë Komuna drutë e konfiskuara nga pylltarët i kanë shpërndarë për raste sociale dhe atë në mënyrën siç kemi vepruar ne me vendim të Kuvendit, mirëpo tani përse vendimi jonë ka ardh si i jashtëligjshëm ndërsa për Komunat tjera vlerësimi nuk ka qenë i njëjtë unë nuk e di. Mirëpo jam në dijeni se paraprakisht është pyetur niveli qendror në çfarë forme ndahen drutë e konfiskuara.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, temën për të cilën po diskutojnë dy parafolësit e kemi edhe si pikë të rendit të ditës, andaj t'i përmbahemi temës aktuale.

z.Avni Fetahu, U.D. drejtor i DKA, theksoi, duke i'u falënderuar për sugjerimet dhe vërejtjet e dhëna ju rikujtoj se ashtu siç e potencoj edhe kolegu parafolës zotëri Fetahu çdo rregullore i kalon fazat përkatëse në Ministrinë përkatëse. Në të njëjtën kohë nenet përkatëse siç është ai 50 janë të harmonizuara qartë që pezullimi i përkohshëm është nga 1 deri në 3 muaj për nxënës dhe që parashihet me Udhëzim Administrativ dhe sa për njohurinë e juaj për çdo shkollë që është mbi 500 nxënës ka edhe sekretarin përkatës në shkollë të cilët kryesisht janë juristë dhe me të cilët e kemi diskutuar shumë hapur çdo çështje, mirëpo mua po më bënë çudi fakti për asambleistin në fjalë i cili ndoshta më mirë do të ishte ta lexonte rregulloren se sa ligjet sepse koga shumë i'a ka huq duke i përmendur ngase nuk kanë asgjë të bëjnë me këtë pjesën tonë.

Pra për çdo nen në këtë rregullore është edhe Udhëzimi se ku është bazuar, ndërsa nëse është në kundërshtim janë organet tjera që e konstatojnë por jo ne t'i japim epitete të tilla si ekonomistët, e që as unë nuk mund ta marrë të drejtën që të them se ka shkelje sepse siç u potencia një rregullore të tillë e ka Komuna e Gjakovës si dhe një varg komunash tjera të cilat veç e kanë kaluar dhe e kanë në fikson dhe e shfrytëzojnë.

z.Qëndrim Softolli, përgjigje drejtorit parafolës, theksoi, rreth njohurive në anën juridike mund të më gjykosh, ndoshta kamë mangësi, mirëpo për secilin nen të rregullores e kam paraqitur edhe ligjin që sipas mendimit tim paraqet shkelje dhe për këtë e marrim përgjigjen më vonë. Jam i bindur se arsimi në Podujevës asesi nuk reformohet nga ajo vegël që çdo ditë e shkel ligjin dhe në secilën ditë të javës i publikohet nga një skandal dhe për këtë çështje do ta trajtojmë ditëve në vijim.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedh në votim këtë propozim rregullore sipas materialit përkatës të dërguar me rendin e ditës dhe konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 33 anëtar/e të Kuvendit të Komunës sa ishin prezent në sallë, me 19 vota PËR, 13 vota KUNDËR dhe 1 votë të PËRMBAJTUR, miratohet propozim Rregullorja sipas materialit përkatës të dërguar në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës.

6. Propozimi për nisjen/inicimin e procedurave për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale (NPL) në Komunën e Podujevës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, pra në këtë pikët të rendit kemi të bëjmë me një nismë e cila ka për qëllim themelimin e një Ndërmarrje Publike në kuadër të Komunës e cila besoj se është shumë e nevojshme ngase për çdo gjë nuk mund të procedohet me tender, shembull për 1 apo disa gropa nuk mund të qiten tenderë, andaj një ndërmarrje e tillë i mungon Komunës së Podujevës, megjithatë ftoj përfaqësuesin e Ekzekutivit të na jap informata më të detajuara.

z.Vigan Salihu, U.D. drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik-DPZHE, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, Ndërmarrja e re Publike Komunale ka për qëllim ofrimin e një game të re të shërbimeve publike me qëllim të përmirësimit të mirëqenies së qytetarëve duke ofruar shërbime efikase publike, rritje të punësimit dhe ekonomizimin e kostove për ofrimin e këtyre shërbimeve.

Kjo Ndërmarrje do të ofroj një numër të madh të shërbimeve sikurse që janë shërbimet e tregut, varrezave, parkingut publik, kanalizimi, gjelbërimi, shtretër lumenjve, dizajnimi i hapësirave publike dhe dekorimi, mirëmbajtja dimërore dhe verore e rrugëve, pyllëzimi i sipërfaqeve, mirëmbajtja e ndriçimit publik e të tjera.

Shërbime që sot nuk ofrohen për qytetarët por që do t'i ofroj kjo ndërmarrje janë edhe mirëmbajtja e varrezave, parkingu publik e të tjera, kurse shërbimet të cilat ofrohen përmes operatorëve ekonomik përmes procesit të tenderimit Komuna e Podujevës brenda vitit shpenzon rreth 400,000.00€ ndërsa këto shërbime planifikohet t'i ofroj kjo Ndërmarrje.

Prandaj dy arsyt kryesore të themelimit të kësaj Ndërmarrjeje janë ekonomizimi i kostove për ofrimin e shërbimeve publike që do të jetë në dobi të tatimpaguesve si dhe ofrimi i shërbimeve të cilat sot nuk ju ofrohen qytetarëve. Shpresoj që ta përkrahni këtë nismë.

z.Naim Çunaku, në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-ës e mbështesim në plotni dhe ka qenë nevojë që të bëhet një menaxhim pak më të mirë i kërkesave të qytetarëve që ndodhin në Komunën tonë si dhe sigurisht se çdo gjë, çdo veprim dhe çdo vendim që është në të mirë të qytetarëve dhe që bindemi se është në të mirë të qytetarëve do ta ketë mbështetjen tonë si Grup.

z.Ardi Hasani, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, theksoi, meqë krijimi i kësaj Ndërmarrje ofron shërbime të reja dhe jo vetëm, rrjedhimisht e lehtëson jetën e qytetarëve ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së e përkrahim propozimin për inicimin e procedurave për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale përkatëse në Komunën e Podujevës.

z.Gazmend Islami, theksoi, po shihet se kur bëhet fjalë për një gjë të mirë i jepet përkrahje nga të gjithë. Pra edhe unë i jap mbështetje të fuqishme krijimit të kësaj Ndërmarrje dhe shpresoj që një Ndërmarrje e tillë do të ofroj dhe kryej shumë shërbime që ndikojnë në rritjen e buxhetit të Komunës andaj për neve është e mirëseardhur. Pra qysh në fillim i thash edhe drejtorit të DBF-ës se komunikimi mes pozitës dhe opozitës për të mirën e qytetarëve duhet të jetë i sinqertë mes vete në mënyrë që për qytetarët llapjan të jemi më të mirë dhe më të dinjitetshëm, prandaj për këtë si asambleist i Ballit Kombëtar Demokrat jam në dakord.

z.Xhevdet Maloku, theksoi, e përshëndes këtë iniciativë të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, për të qenë sa më efikase dhe më e suksesshme kjo Ndërmarrje në ofrimin e atyre shërbimeve fillimisht konsideroj se duhet të ketë konsultime apo tryeza të diskutimit të grupeve punuese së bashku me ekspert të fushave që i mbulon aktiviteti i kësaj Ndërmarrje.

Tek shërbimi i cekur nga Drejtoria, që ka të bëjë me mirëmbajtjen e varrezave është një shërbim që është duke na munguar neve sidomos në fshatra andaj duhet pasuar parasysh edhe konsultimi paraprak edhe me Bashkësitë fetare të Podujevës.

Tek shërbimi i parkingut publik, është një ndër shërbimet më të rëndësishme që do të ofronte kjo Ndërmarrje por që ai shërbim të jetë sa më efikas Komuna jonë ka nevojë edhe për një Rregullore e cila rregullon dhe organizon shfrytëzimin e parkingut të komunës, parkingjeve me Partneritet Publiko Privat-PPP, kushtet dhe mënyrën e pagesës si dhe llojet e buletave.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedh në votim propozimin për nisjen/inicimin e procedurave për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale në Komunën e Podujevës, sipas materialit të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje dhe Konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 33 anëtar/e të Kuvendit të Komunës sa ishin prezent në sallë, njëzëri me 33 vota PËR, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur, me vendim miratohet propozimi për nisjen/inicimin e procedurave për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale (NPL) në Komunën e Podujevës, sipas materialit përkatës të dërguar në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës, dhe konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

7. Propozim Vendimi për themelimin dhe përbërjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi - KKSBB në Komunën e Podujevës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, së bashku me material e kësaj pike e keni marrë edhe listën e të propozuarve për këtë Këshill, kështu që emrat i keni parë besoj, një emër mungon që duhet t'i bashkëngjitet Këshillit dhe është kryesuesi/ja i/e Komitetit për Komunitete, Komitet i cili nuk është formuar ende sepse është kthyer me rekomandime nga Ministria përkatëse por që në vazhdim e kemi pikë të rendit të ditës dhe i e sqarojmë këtë, por që Kryesuesi/ja i/e këtij Komiteti është edhe anëtar/e me automatizëm në KKSBB.

znj.Donjetë Sheqiri, në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e LDK-së e përkrahim propozim vendimin përkatës për themelimin dhe përbërjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSBB.

z.Ragip Fetahu, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, theksoi, kam një pyetje për Ekzekutivin e Komunës, kush i emëron dhe mbi çfarë baze emërohen këta përfaqësuesit e bashkësive lokale.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, sa për sqarim, KKSBB nuk themelohet nga Ekzekutivi i Komunës por nga Kuvendi i Komunës.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSBB themelohet konform një Udhëzimi Administrativ të MAPL / MPB dhe parashihen gjitha pozitat përkatëse ku disa janë me automatizëm sipas detyrës zyrtare kurse disa me propozimet e akterëve përkatës. Sa i përket pozitave për të cilat pati pyetje këshilltari parafolës, (Këshillat Lokale për Siguri në Bashkësi-KLSB në Orllan dhe Kërpimeh) janë përfaqësues të cilët i emëron/zgjedh dhe propozon Policia e Kosovës.

Pra siç shihet brenda këtij KKSBB ka edhe zyrtar të Ekzekutivit, edhe përfaqësues të Komuniteteve jo shumicë por edhe përfaqësues të subjekteve tjera siç janë Shoqata, OJQ e të tjera, pra kemi kryetarin e Këshillit të Bashkësisë Islame, Zjarrëfikës, OJQ, e të tjerë, pra me një fjalë janë të gjitha organizimet të cilat përfshijë jetën e organizuar brenda për brenda Komunës.

z.Ragip Fetahu, theksoi, unë fjalën e kisha për këta përfaqësuesit e bashkësive lokale Orllan dhe Kërpimëh, pra thjesht më intereson qysh këta njerëz i përfaqësojnë ato bashkësi.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, për pyetjet e parashtruara nga këshilltari z.Ragip Fetahu, nëse dëshiron më në detaje përgjigjen mund t'ia jep zyra ligjore ditëve në vijim.

Atëherë nëse nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, unë e hedh në votim propozim vendimin për themelimin dhe përbërjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB, sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, Konstatimet e rekomanduara nga Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 31 anëtar/e të Kuvendit të Komunës sa ishin prezent në sallë, njëzëri me 31 vota PËR, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur, miratohet propozim vendimi sipas materialit përkatës të dërguar në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës, Konstatimeve të rekomanduara nga Komitetit për Politikë dhe Financa, si dhe me përfundimin që pasi të zgjedhjet kryesuesi/ja i/e Komitetit për Komunitete, është pjesë e përbërjes së KKSB-së me automatizëm ashtu siç parashihet me Udhëzimin përkatës Administrativ.

8. Propozim Rregullorja për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestrës Sportive

“Hakif Zejnullahu” në Podujevë

- Propozim vendimi për vënie në diskutim publik

z.Pajtim Balaj, U.D. drejtor i Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit-DKRS, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, ne si DKRS propozojmë vendim për vënie në diskutim publik të propozim rregullores për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestrës Sportive “Hakif Zejnullahu” në Podujevë.

Diskutimi publik sipas nenit 1 të këtij propozim vendimi zgjatë 30 ditë, përkatësisht prej datës 09 maj 2022 deri më 09 qershor 2022, brenda së cilës DKRS mund të organizoj diskutime të ndryshme kurse debati publik me qytetarë mbahet po në këtë sallë më datë 18 maj 2022 në ora 10:00. Propozimet, sugjerimet apo vërejtjet që mund të jenë për draftin e propozuar të rregullores mund të paraqiten në ditën e debatit publik por edhe në Zyrën për marrëdhënie me publikun dhe informim por edhe në e-mail adresën e shefit të sektorit jakup.gashi@rks-gov.net të cilat pastaj shqyrtohen dhe prezantohen në rregulloren finale e cila do t'i paraqitet Kuvendit për miratim final.

Gjithashtu një sqarim shtesë, pjesa e tarifave për shfrytëzim të palestrës, reklamim e të ngjashme janë të inkuorpuara në rregulloren për taksa tarifa dhe gjoba komunale.

znj.Donjetë Sheqiri, në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së e mbështesim propozim vendimin për vënie në diskutim publik të propozim rregullores për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestrës Sportive “Hakif Zejnullahu” në Podujevë, ndërsa kontributin tonë me rekomandime dhe propozime do ta japim gjatë fazës së diskutimit publik.

z.Bahri Blakçori, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së e përkrah këtë propozim rregullore që e njëjta të kalojë në diskutim publik. Ftoj të gjithë sportistët veçanërisht ekipet të cilat shfrytëzojnë atë Palestër që me sugjerimet apo edhe vërejtjet eventuale të tyre ose idetë e tyre kreative të mundësojnë që kjo rregullore të jetë sa më e pasuruar në kuptimin e plotësimit të saj gjatë fazës së diskutimit publik.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën e hedh në votim propozim vendimin përkatës sipas të cilit propozim rregullorja vëhet në diskutim publik, përfshirë edhe propozimet e drejtorit të DKRS lidhur me kohëzgjatjen dhe datat e diskutimit/debatit publik me qytetar.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 30 anëtar/e të Kuvendit të Komunës sa ishin prezent në sallë, njëzëri me 30 vota PËR, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur, miratohet propozim vendimi sipas materialit përkatës të dërguar në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës, me plotësim ndryshimet, përkatësisht propozimet e drejtorit të DKRS-së rreth kohëzgjatjes së diskutimit publik dhe datat e diskutimit/debatit publik, dhe atë;

Diskutimi publik zgjat 30 ditë përkatësisht prej 09 maj 2022 deri më 09 qershor 2022, brenda së cilës Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit mund të organizoj diskutime të ndryshme, kurse Debati publik me qytetarë mbahet më 18 maj 2022 duke filluar nga ora 10;00, në ndërtesën e re të Komunës, kati përdhes - salla e mbledhjeve.

znj.Donjetë Sheqiri, kërkoj nga Kryesuesi i Kuvendit të rishqyrtoj mundësinë që pjesa e mbetur e kësaj seance të vazhdohet një ditë tjetër kurdo që pajtohemi të gjithë.

Kryesuesi i Kuvendit, përgjigjem parafolëses, theksoi, për propozimin e juaj e nderuar u votua njëherë në fillim të mbledhjes dhe tani nuk mund të votohet dy herë për të njëjtën çështje.

z.Xhevdet Maloku, theksoi, sa i përket pauzës kërkoj mirëkuptim nga të gjithë që nëse ka mundësi të propozohet dhe të ketë pauzë afër kohës së faljes së xhumasë ngase jemi disa anëtar/e të Kuvendit këtu që shkojmë. Pra mundësisht të kemi pauzë afër orës 13;00 dhe besoj se kthehemi rreth orës 13;50.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, konsideroj se mund të vazhdojmë me seancën deri në ora 12;45 e pastaj të shkojmë në pauzë për 1 orë e 30 minuta, nëse veç pajtoheni shumica.

9. Propozim Rregullorja për taksa tarifa dhe gjoba komunale - Propozim vendimi për vënie në diskutim publik

z.Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, Komuna e Podujevës e ka një rregullore në fuqi për taksa tarifa dhe gjoba komunale e cila daton nga viti 2018, pastaj në vitin 2021 janë bërë disa plotësime ndryshime kurse tani është shtruar si nevojë e ndryshimit të kësaj rregulloreje dhe ne e kemi hartuar këtë draft të cilin e keni paravetës por që paraprakisht kërkohet që e njëjta të vëhet në diskutim publik për të paktën 30 ditë ashtu siç përcaktohet edhe ligj.

Një pjesë dërmuese e kësaj rregulloreje vazhdon të mbetet e njëjtë, ndryshimet janë te taksa për ushtrimin e veprimtarisë afariste ku po thuajse rreth 98% të bizneseve janë të liruar nga kjo taksë përjashtimisht disa biznese të cilat konsiderohen se kanë një gjiro dhe fitim shumë të lartë se bizneset tjera dhe i'u është vënë një taksë për të cilën konsiderohet se është reale dhe nuk është e lartë. Gjithashtu kemi vënë lehtësime edhe te bizneset prodhuese dhe te lejet e ndërtimit ku pothuajse kemi larguar këtë taksë dhe pothuajse ka mbetur një taksë vetëm simbolike, janë edhe disa ndryshime të tjera por sido që të jetë të gjitha propozimet dhe vërejtjet ne mund t'i marrim edhe tani mirëpo edhe gjatë kohëzgjatjes së diskutimit publik për çka jemi të hapur që ta ndryshojmë dhe plotësojmë edhe me propozime të reja të cilat normalisht që mund të jenë të arsyeshme.

Periudhë të diskutimit publik propozoj të jetë nga 09 maj 2022 deri më 09 qershor 2022, kurse më 23 maj nga ora 16;00 të mbahet debati me qytetarë, duke mos harruar ta cekë se po ashtu vërejtjet apo propozimet mund t'i përcjellëni edhe me shkrim, si dhe çështje tjera me rëndësi që janë paraparë edhe në propozim vendimin përkatës.

z.Arjant Topanica, në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së e përkrahë propozim vendimin për vëni në diskutim publik të propozim rregullores për taksa tarifa dhe gjoba komunale, ndërsa vërejtjet dhe sugjerimet tona si dhe gjithçka çka kemi rreth kësaj rregulloreje do ta bëjmë gjatë kohëzgjatjes së diskutimit publik rreth kësaj pike.

z.Xhevdet Maloku, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, theksoi, kjo rregullore ka rëndësi të madhe për bizneset që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Llap. Vazhdimisht me vite të gjithë e kemi pasë një breng të përbashkët që ka qenë kalimi i bizneseve në drejtim të Komunave tjera, kuptohet se nuk është taksa ajo që ka ndikuar në largimin e bizneseve sepse ka shumë faktorë tjerë që renditen në top listë. Mënyra e vendosjes së taksave është koncepti që kemi për shoqërinë tonë në të cilën jetojmë dhe që dëshirojmë ta ndërtojmë. Disa vite me radhë bizneset tona u prekën nga Pandemia Covid 19, kurse në këtë vit janë duke u ballafaquar me krizën tjetër ekonomike, pra përmbledhur me një fjalë janë në një periudhë që kanë nevojë për t'i mbështetur në çfarëdo mënyre që ekziston.

Propozoj që të shqyrtohet mundësia që bizneseve të vogla dhe atyre si, gastronomia dhe qendrat tregtare me prejardhje nga Llapi të përfitojnë nga një vendim i taksave deri në 50% të shumave të cekura në materialet e pranura dhe ku tolerim të jetë vetëm për vitin 2022, e gjithë kjo për t'i fuqizuar bizneset llapjane për tejkalimin e krizës aktuale.

Taksa idelae është ajo taksë e cila nxitë rritjen ekonomike duke shtuar vende të reja të punës apo duke mos shtuar nivelin e papunësisë siç ndodhi gjatë pandemisë.

Sa i përket tarifave për shërbime publike, mendoj se duhet të merret parasysh rritja çmimit të materialit transportiv dhe kësi soji të vendosin çmime reale të tregut në rastet kur ndodh prerja e asfaltit nga ana e bizneseve për nevojat e tyre, pra fjala është për nenin 10 të kësaj draft rregulloreje. Tek neni 17 propozoj që kërkesa për subvencionim në bujqësi të jetë pa pagesë, si dhe për fund në emër të grupit të këshilltarëve të LVV-së e mbështesim që kjo propozim rregullore të vëhet në diskutim publik, dhe këto që i potencova të vlejnjë si dhe çështje tjera që mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së diskutimit publik.

z.Bashkim Sylja, në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK-së, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve të PDK-së jemi që kjo propozim rregullore të vëhet në diskutim publik, kurse gjatë diskutimit publik do të japim vërejtjet dhe sugjerimet tona.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedh në votim propozim vendimin për vënie në diskutim publik të propozim rregullores sipas kësaj pike të rendit të ditës, përfshirë edhe rekomandimet nga mbledhja e KPF-së dhe propozimet e drejtorit të DBF të bëra në fjalën hyrëse.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 29 anëtar/e të Kuvendit të Komunës sa ishin prezent për momentin në sallë, njëzëri me 29 vota PËR, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur, miratohet propozim vendimi sipas materialit përkatës të dërguar në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës, me plotësim ndryshimet, përkatësisht propozimet e drejtorit të DBF-së rreth kohëzgjatjes së diskutimit publik dhe datat e diskutimit/debatit publik, dhe atë;

Diskutimi publik zgjat 30 ditë përkatësisht prej 09 maj 2022 deri më 09 qershor 2022, brenda së cilës Drejtoritë përkatëse mund të organizojnë diskutime të ndryshme, kurse Debatit publik me qytetarë mbahet më 23 maj 2022 duke filluar nga ora 16:00, në ndërtesën e re të Komunës, kati përdhes - salla e mbledhjeve.

z.Valon Demolli, në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së kërkoj 1 orë pauzë.

z.Ragip Fetahu, theksoi, mendoj se shumë më rëndësi po i kushtojmë pauzave se sa pikave dhe çështjeve që janë me rëndësi për t'i trajtuar, kjo edhe për faktin se një herë në muaj po mbajmë mbledhje dhe nuk po e kuptoj këtë dëshirën për pauza të vazhdueshme, megjithatë meqë jemi në ramazan dhe tani është koha e faljes së xhumasë po e respektojmë këtë traditë tonën, andaj pajtoj që të kemi pauzë për rreth 1 orë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, kjo çështje u diskutua edhe më parë në këtë mbledhje dhe ishte propozim i këshilltarit z.Xhevdet Maloku dhe tani propozim edhe këshilltarit tjetër z.Valon Demolli, prandaj ne u pajtuam për këtë pothuajse mirëpo vetëm të gjejmë kohën e përshtatshme për këtë pauzë.

Pas diskutimeve, mbështet propozimi për pauzë për 1 orë, përkatësisht nga tani 12;30 deri më 13;30

Kuvendi shkon në pauzë për 1 orë, përkatësisht nga ora 12:30

Pas pauzës, mbledhja vazhdon duke filluar nga ora 13:55

Kryesuesi i Kuvendit, e hapi vazhdimin e mbledhjes duke konstatuar kuorumin ku prezent për momentin në sallë janë 32 këshilltarë/e të Kuvendit të Komunës, duke rikujtuar pikën ku është mbetur me punime me rastin e dhënies së pauzës.

10. Raporti vjetor financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021

z.Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth këtij raporti, ndër të tjera theksoi, raporti financiar për vitin 2022 është hartuar në përputhje me ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, më lejoni që para jush të paraqes në formë të shkurtër pikat kryesore të këtij raporti financiar, meqë materialin e keni marrë me kohë andaj prezantimin po e bëjmë në mënyrë më të shkurtër edhe pse bëhet fjalë për një dokument voluminoz. Shpenzimet buxhetore, buxheti për vitin 2021 nga shuma totale që ka qenë 23,853,654.00€, nga këto 12,550,000.00€ kanë qenë në kategorinë e pagave, 2,533,578.00€ në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, 420,000.00€ në shpenzimet komunale, 750,050.00€ në kategorinë e subvencioneve dhe 7,600,026.00€ në investime kapitale. Nga kjo vlen të ceket se 1,125,298.00€ kanë qenë të alokuara në klauzolën e investimeve, përndryshe ky projekt ka pasë të bëj me kolektorin e ujërave të zeza dhe një sqarim për këtë çështje se kjo shumë buxhetore për përmbylljen e këtij projekti që ka qenë për kolektorin e ujërave të zeza janë nevojitur vetëm 326,000.00€, mirëpo në planifikim ka figuruar si 1,125,000.00€, edhe pse kanë qenë të panevojshme dhe të pa mundura të shfrytëzohen në këtë masë për arsye se këto janë rregulluar përmes marrëveshjes ndërkombëtare për kredi për ndërtimin e këtij kolektori të ujërave të zeza.

Shpenzimet buxhetore kanë arritur në 22,218,657.00€ apo 88.59% e buxhetit të alokuar që ka qenë 25,080,126.00€. Nga granti qeveritar janë shpenzuar 20,767,918.00€, dhe nga të hyrat vetanake 1,326,580.00€. Ashtu siç e ceka më parë kjo klauzola për investime për kolektorin e ujërave të zeza që ka figuruar për vitin 2021, vetëm 321,206.079€ janë mjete që faktikisht i takojnë këtij buxheti, pjesa tjetër nuk e di qysh ka ardhë sepse nuk kemi qenë ne në atë fazë, më shumë në mënyrë fiktive ka figuruar. Shpenzimet për paga dhe mëditje janë 12,881.047€, apo 100% e shumës së buxhetit të alokuar, shpenzimet për mallra gjatë vitit 2021 janë 2,583,473.00€ apo 92.23% e shumës së alokuar prej 2,801,167.00€, shpenzimet për komunalitet 410,000.040€ që do të thotë se janë shpenzuar 97.63% e buxhetit të alokuar për këtë kategori ekonomike që ka qenë 420,000.00€, shpenzimet për subvencione dhe transfere shënuan vlerën 703,733.00€ apo 78.38% e buxhetit të alokuar prej

897,000.00€. Në qoftë se e marrim në tërësi buxhetin për vitin 2021, duke zbritur klauzolën e investimeve që është kredi dhe është realizuar 92.75%.

Këto ishin disa pika të shkurtra të këtij raporti financiar. Raportin e keni marrë me kohë të gjithë e keni para vetës andaj edhe mund të diskutojmë.

z.Qëndrim Softolli, nga radhët e Grupit të këshilltarëve të LDK-së, theksoi, raporti financiar është një dokument që duhet t'i kushtohet rëndësi nga të gjithë ne pasi që është një pasqyrë e shpenzimeve të parasë publike. Nga buxheti i paraparë që ka qenë rreth 25,000,000.00€, janë shpenzuar 22,200,000.00€, kemi një shumë prej 300,000.00€ të pa shfrytëzuara ose të keq menaxhuara ose keq planifikuara nëse mund t'i quaj nga Ekzekutivi i Komunës për vitin 2021.

Nga buxheti i alokuar për vitin 2021 kanë mbetur këto mjete të pa shpenzuara, nga grandit qeveritar mbi 900,000.00€, nga të hyrat vetanake kanë mbetur rreth 700,000.00€, nga donatorët e brendshëm kanë mbetur rreth 150,000.00€, nga financimi nga huamarrja për klauzolën e investimeve kanë mbetur mbi 1,000,000.00€, pra mjetet e ndara nga grandit qeveritar afër 1,000,000.00€ kthehen në thesar si rezultat i keq menaxhimit apo keq planifikimit. Nga të hyrat vetanake kemi një shumë rreth 700,000.00€, të cilat nuk arritën të menaxhohen në mënyrën e duhur. Qytetarë të dashur vlerësojeni vet se sa projekte do të mund të realizoheshin nga kjo shumë e mbetur.

Te shpenzimet për subvencione dhe transfere kemi një shumë rreth 200,000.00€ të pa shpenzuar, pra kjo tregon saktë sa janë të gatshëm t'ju qëndrojnë afër qytetarëve të komunës tonë dhe t'i asistojnë ata në fusha të ndryshme. Te shpenzimet kapitale kemi mbi 800,000.00€, të pa shpenzuara, pra kjo nuk ka emër tjetër veç se dështim të atyre që keq menaxhuan në realizimin e këtyre mjeteve, brenda këtij raporti kemi një numër të madh të shpenzimeve të pa arsyeshme dhe si të dyshimta për keqpërdorim, kemi një përshkrim për pajisje tjera në shumë afër 40,000.00€, mëditje të udhëtimeve 872€, shpenzime të udhëtimit jashtë vendit mbi 1000€, shpenzime të vogla para xhepi mbi 1000€ përshkrim interesant kjo, pastaj akomodimi i udhëtimeve zyrtare jashtë vendit mbi 500€, pra kemi mbi 3,600.00€ shpenzime për udhëtime zyrtare dhe sa kemi pa hajr prej tyre mbetet të shihet. Shërbime tjera kontraktuese me një shumë prej 744,000.00€ nuk dihet fare se çfarë shpenzimesh janë këto pastaj kemi përshkrimin, pajisje prej 1000€, me një shumë afër 350,000.00€, dreka zyrtare janë shpenzuar mbi 2000€, është përshkrimi mobilet me shumë 26,000.00€, mirëmbajtje rutinore kemi 54,664.00€, kisha dashur më detajisht prej drejtorit të na tregoj se çka përmbajnë, kemi përshkrimin prapë pajisje tjera në vlerë 238,000.00€, prapë pajisje tjera 1,172.00€, vetëm te përshkrimi pajisje tjera janë shpenzuar mbi 770,000.00€, nuk dihet saktë çfarë pajisjesh dhe për çka janë shpenzuar këto të holla.

Unë paraqita vetëm disa shqetësime tona rreth realizimit të këtij buxheti që në përfundim mund ta quaj dështim në jetësimin e shumë projekteve në interes të qytetarëve të komunës sonë.

z.Artrit Mulliqi, nga radhët e Grupit të këshilltarëve të LVV-së, theksoi, raporti vjetor financiar përfshinë vitin fiskal 2021, pra përfshin periudhën kohore prej 01.01.2021 deri më datë 31.12.2021. Për performancën e shpenzimeve foli më herët drejtori dhe ajo që më bëri përshtypje janë të hyrat vetanake, do të thotë të hyrat vetanake gjatë vitit 2021 janë tejkaluar.

Duke qenë se planifikimi për të hyrat vetanake ka qenë 1,342,599.00€, do të thotë realizmi veç sa është tejkaluar 1,691,926.00€, ose marrë në përqindje 126%, më shumë, krahasuar me vitin 2020, realizimi ka qenë 51.15% më i lartë, andaj duke marrë parasysh performancën e shpenzimeve ne si Grup i këshilltarëve të LVV-së, e përkrahim këtë raport financiar.

z.Naim Çunaku, theksoi, të debatosh për raportin financiar, gjegjësisht për shpenzimet e buxhetit dhe me ato projeksione që kanë qenë të miratuara nga Kuvendi i Komunës si qëllim në vete për lehtësimin e jetës së qytetarëve dhe ne si Kuvend një prej detyrave primare kemi monitorimin e shpenzimit dhe monitorimin e realizimit të këtyre projekteve. Atë që e cekën parafolësit e në veçanti

nga parafolësi im nga Grupi që edhe unë i takoj, ishte shqetësuese që kemi një mbetje të buxhetit që nuk është realizuar, pa dashur me hy në atë se çka do të mund të bëhej dhe a i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e qytetarëve apo s'kanë pasë nevojë qytetarët e Komunës së Podujevës për këto projekte. Unë e di se shumë prej tyre kanë pasë nevojë për projekte dhe janë kthyer mbrapa me arsye se kemi mungesë të buxhetit dhe në fund po del që buxheti ka tepruar në masë që është lexuar disa herë por që edhe atyre tjerëve ju ka tepruar edhe dje në mbledhjen e KPF-së e thash nëse dikush dëshiron të marrë referencë diçka të cilën e ka kritikuar dhe atë e ngritë se nuk e ka bërë sa ai keq ose njësoj si ai keq, nuk mendoj se jemi mirë.

Diçka tjetër që desha ta potencoj, në mbledhjen e datës 28.02.2022 në fillim të seancës e përmenda se kemi pasë një rend dite të ngarkuar dhe për habinë dhe çudinë tonë po në atë seancë u paraqit një plan i punës së Kuvendit dhe pa i kaluar procedurat, gjegjësisht duke e shkelë rregulloren e miratuar një plan të punës për punën e Kuvendit. Për njohurin e juaj po e citoj planin e punës që e kemi pasë për seancën e muajit mars që prej kohës kur është miratuar e deri më tani kemi afërsisht dy muaj dhe për dy muaj bëjmë një shkëputje kaq të madhe nga një plan që e kemi realizuar para dy muajve, për mua është shqetësuese. Po lexoj, ka qenë e planifikuar raporti financiar 2021, edhe dje dhe sot Raporti financiar paraqitet para Kuvendit si kategori kushtetuese për raportime periodike dhe vjetore dhe data e fundit kur paraqitet një raport financiar para Kuvendit është e përcaktuar me ligjin mbi financat, e ajo datë është 31 marsi. Sot po më duket se nuk jemi më 31 mars por jemi bukur larg 31 marsit, do të thotë raporti financiar nuk ka kaluar në muajin mars. Raportin e punës së Kryetarit nuk e kemi pasur në muajin mars, e kemi në plan të punës zotëri Kryesues dhe të nderuar këshilltar, informatën e përgjithshme nga Drejtoria e Inspeksionit nuk e kemi dhe po ashtu edhe këtë e kemi pasë për muajin mars, informatë e përgjithshme nga Drejtoria e Pronës kadastrit dhe Gjeodezisë as këtë nuk e kemi pasë, informatë e përgjithshme nga Drejtoria e kulturës Rinisë dhe Sportit as këtë se kemi pasë, mandej kemi pasur miratimin e Hartës Zonale për të cilën e dimë arsyen shkaku i procedurave që nuk janë varur nga ne dhe nënkuptohet si rast, pastaj informatë e detajuar për punën e prokurimit gjegjësisht planin e prokurimit, dhe asnjë nga këto nuk i kemi pasur në muajin mars, a kemi në muajin prill jo, deri kur, e kam fjalën për muajin mars që kaloj. Këtë s'ka si t'a quaj ndryshe vetëm si një fillim jo i mirë i punës sonë dhe jo në nivelin e duhur nga ne por jo për fajin tonë.

z.Fatlum Osmani, U.D. drejtor i DBF-së, theksoi, raporti financiar pa dyshim se është një dokument i rëndësishëm dhe rrjedhimisht tregon performancën financiare të Komunës së Podujevës përgjatë një viti. Nga ajo që u tha te çështja e kritikave dhe vërejtjeve te keq klasifikimet dhe mbetja buxhetore Raporti për të cilin sot po diskutojmë është mbi bazën e buxhetit të vitit 2021, atë buxhet nuk e kemi planifikuar ne, andaj kjo ishte kritikë ndaj vetes, në rregull kjo është për tu vlerësuar në rast se njeriu e kritikon edhe vetën.

Sa i përket mbetjes buxhetore e vërteta është se kryesisht është pak më shqetësuese kur është nga granti qeveritar se ato mjete kalojnë në suficid dhe rrjedhimisht nuk mund të shfrytëzohen më nga Komuna e Podujevës. Sa i takon mjeteve buxhetore nga të hyrat vetanake, ne sot e bëmë bartjen e të hyrave vetanake dhe ato mjete për projekte mund të shpenzohen që i bie se nuk është ndonjë dëm i madh i Komunës së Podujevës. Mbetjet nga grandit qeveritar janë afër 900,000.00€, vitin e kaluar kanë qenë 2,200,000.00€, po them që mos të krahasohet sepse ka një arsye që nuk vlen të krahasohet me buxhetin e kaluar por si do që të jetë janë afër 2.5 herë më pak mbetje buxhetore. Pse ka ardhë deri te kjo mbetje buxhetore në shumë rreth 900,000.00€ është shumë e rëndësishme të dihet, buxheti planifikohet në muajin shtator për vitin vijues dhe çdo qeverisje kur planifikon buxhetin në muajin shtator fillon nga një pikë fillestare pastaj nënkupton që nga ajo duhet të përgatiten projektet, specifikimet teknike të atyre projekteve, lëndët e prokurimit në mënyrë që ato të procedohen me kohë në prokurim dhe ajo që është shumë e rëndësishme është që kontratat të lidhen me kohë dhe

realizimi i projekteve të shkojë në dinamikën dhe kohën e paraparë dhe rrjedhimisht të mos kemi suficid. Drejtoritë që kanë pasë të bëjnë me investime kapitaleve por jo vetëm te investimet kapitale se edhe mallrat dhe shërbimet kanë disa projekte dhe disa përshkrime, nuk ka ekzistuar asnjë projekt në Komunën e Podujevës i gatshëm për prokurim, përpos kësaj Komuna e Podujevës nuk e ka pasë as kontratën për hartimin e projektit që është e domosdoshme sepse ka shumë raste kur Komuna ka mungesë të kapaciteteve njerëzore, të inxhinierëve për të hartuar projekte, tash rrjedhimisht kjo e ka vonuar tepër shumë planin dhe fillimin e procedurave të prokurimit sepse pa përshkrime të procedurave të projekteve nuk mund të vazhdojë në procedurat e prokurimit. Me gjithë këto zhvillime dhe arsyetime të cilat i paraqita nuk dua të marrë një arsyeshmëri të fortë por seriozisht është sukses i jashtëzakonshëm ku kemi arritur sepse këto dy gjëra janë shumë të rëndësishme, përshkrimi teknik i një projekti dhe kontrata për hartim të një projekti ngase këtë komunë me 5 inxhinier e keni lënë për 20 vjet, unë s'kam çare këtë pa ua përmend, këtu keni vepruar ashtu siç ju kanë dashur eventualisht nëse ju ka qëlluar dikush i afërm jurist iu është dashur ta pranoni, ka punë apo s'ka s'është me rëndësi, s'ka qëlluar djali i tezes inxhinier çka me i bë, nuk është dashur me i shpallë konkurs. Tani me planifikimin e buxhetit për vitin 2022 është planifikuar pranimi i inxhinierëve të ri dhe do të ketë rritje të kapaciteteve por edhe kontrata për projekte e që besoj se kjo problematikë 20 vjeçare nuk do të ekzistojë për vitin 2022.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, faleminderit drejtor që i dhatë një mal arsyesh për mbetjen buxhetore, por mbetja buxhetore është një fakt dhe e dimë që numrat nuk gënjejnë, se si e arsyeton është punë e juaja. Keq menaxhimit nuk mundet me i ikë me gjithë ato mbetje buxhetore në vitin 2021.

Sa i përket dajve dhe tezeve tashmë po shihet nuk kemi pse ta diskutojmë këtë temë se dasëm e kanë bërë në të gjitha institucionet në rrethin sa më të ngushtë. Sa i përket thirrjes 20 vjeçare të kisha lutur të shikosh pak rreth vetës se kënd e ke pasë në udhëheqje dhe në Ekzekutiv dhe këqyre anën tonë se cili ka qenë në Ekzekutiv ose në udhëheqje për 20 vite.

z.Gazmend Islami, theksoi, qysh në fillim dua t'ju sugjeroj pak që mos të jeni nguca keq por këta që janë në LVV herë prapësohen në shkollën e tyre juridike, dhe a po e shihni se ky (drejtori i DBF-së) s'mund të rrijë pa folë pak pa u kap dikund, e kjo nuk na çon askund, kjo më shumë duket si banalitet. Të debatoj tash unë me ty jo ke qenë LDK, i keni 5 inxhinier ose arkitekt.

A mund të jesh më i singertë në komunikim drejtor, këtë po e kërkoj sepse është gjë e logjikshme për çdo njërin. Ti je drejtor duhet të jesh shembull para qytetarëve, duhet me pasë kulturë komunikimi. Sa i përket këtyre pajisjeve në vlerë 700,000.00€, çka është puna e tyre se në Gjermani shkon në burg nëse nuk e portretizon qoftë edhe për një kompjuter, kurse 700,000.00€, janë shumë e madhe. Unë jam përkrahës i çdo pune të mirë që punohet në dobi të qytetarëve por jam kundër këtyre fërkimeve politike, dhe ju betohem se po t'i përmend se çka jeni duke bërë ju, e që përtoj të flas, asgjë më të mirë nuk jeni.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, ju kërkoj të gjithëve që të mos dalin jashtë teme, nuk jemi ne për politika të mëdha, ne e dimë se kemi dhënë një betim që do të punojmë për interesat e qytetarëve, po të donim të merreshim me politika të mëdha do të ishim në Kuvendin e Republikës së Kosovës e jo këtu në Kuvendin Komunal, kështu që të merremi me tema konkrete e mos të dalim jashtë temave që janë të parapara në rendin e ditës, dhe këtë e arsyetoj me ankesën e disave se kemi shumë pika të rendit të ditës, andaj mos të marrim kohë më tepër.

z.Naim Çunaku, theksoi, se sa do të jemi të shkurtër të paktën në fillim të mbledhjes tregova që nuk kisha dashur të ndodh ajo që në një formë ka tentim të instalimit derisa të gjejnë një formë tjetër, përmbytja e debatit në Kuvend nuk i lejohej askujt pavarësisht se në cilën karrige është ulur qoftë përballë nesh qoftë në mesin tonë, fundja atë nuk e lejon demokracia e nuk do ta lejojmë as ne. Të drejtën e debatit dhe mbytyjen e debatit të kuvendarëve karshi asaj që e kanë mision ta kryejnë nuk

mund t'ia pranojmë askujt, kjo ishte nga ajo që unë në fillim e thash se kemi një rend të ditës të gjatë por nuk mund ta shkurtojmë debatin në kuptimin e asaj se kemi shumë pika të rendit të ditës. Se a janë shumë pika të rendit të ditës, ato janë parë dhe kanë kaluar në KPF, ishte propozimi dhe u hedh në votim, po dalim në një temë tjetër po bëjmë një krahasim që para vetes pata një plan të punës së Kuvendit dhe pyeta se nga ato tema që ka paraparë Kuvendi për muajin mars asnjë nuk është miratuar, këtu jemi keq me vetën tonë, në veçanti dokument i rëndësishëm është plani i punës së zyrës së prokurimit, përmes kësaj zyre realizohen projektet, gjegjësisht e dimë se në cilën fazë jemi në realizimin e projekteve.

Drejtori më bërë të flasë dhe po mundohem të them decidivisht, të hyrat vetanake nuk është problem që nuk janë shpenzuar dhe ato mjete nuk humbin, madje nuk humbin as të hyrat vetanake e as grandit qeveritar sepse në Kosovë mbesin, madje madje tani kur e kemi të njëjtin pushtet si në nivelin lokal dhe atë qendror prapë të njëjtat vija menaxhuese na mbesin, mirëpo çfarë më bëri përshtypje është se nuk e di në vitin e ardhëm çka do të thuhet ngase për këtë vit dihet kush është kujdestar fajtor, është një pushtet tjetër që dikush mund ta mohoj atë arsyetim, por për mua nuk është arsyetim se njeriu e merr përgjegjësinë prej atë ku fillon dhe ky Ekzekutiv ka marrë punën para vitit të ri dhe komplet e ka angazhuar atë buxhet dhe për mua nuk është arsyetim, nëse dikush e pranon që vazhdimisht duhet të thuhet që jemi më mirë se kur ka qenë LDK-ja ose se këtu LDK-ja e ka bërë keq e që edhe mund ta përdorë ashtu, po për mua s'është arsyetim.

Diçka i nderuar drejtor i DBF-së ngapak po keni qejf me më 'ngucë' e që edhe parafolësi zotëri Islami ju tha që mos "ngucni" sepse pastaj po kalojmë në temë tjetër, pra hyre në temën e stafit të cilin e ka gjet LVV-ja me ardhjen në pushtet dhe se sa kanë qenë profesional e kemi pa kur kanë mbet vetëm 4 veta në zyre të hartimit të projekteve. Pa dashur të të bëhem i mençur unë e di se nëse ka mungesë kapacitetesh Komuna e ka të drejtën të kontraktoj kompani për projekte, e që s'është aspak arsye ajo që ju e thatë sepse ne mund të nisemi edhe prej profesionalizmit të Ekzekutivit çfarë është, a kanë kualifikime përkatëse për Drejtoritë që i menaxhojnë e që unë e di se janë pozita menaxhuese sepse hyjnë juristë e ekonomistë por edhe këtu ka njerëz me profesione të ndryshme që udhëheqin krejt Drejtori tjera që s'janë të ndërlidhura me profesionin e tyre, por fundja ajo është përzgjedhje e dikujt tjetër, ata kanë mandat politik dhe unë këtë duhet ta pranoj, por unë nuk mund të dyshoj në profesionalizmin e dikujt pse se ka një diplomë të juridikut e s'po dua se po më vjen keq sepse janë drejtor dhe s'dua ta marrë një profesion që s'ka të bëjë fare me të por fundja është staf politik dhe përzgjedhja bëhet politike, pra nuk kisha dashur të lëshohemi në kualifikimet e njerëzve për pozitën që i udhëheqin.

Diçka tjetër sa i përket kritikave dhe se nuk mund t'i iku ngase e kam pyetur drejtorin e DBF-së se a e din se kemi një tejkallim të afateve kohore të raportimit financiar që është data 31 mars dhe sigurisht ndoshta ju kujtohet kjo drejtor sepse ka koleg që ishin aty prezent, dhe përgjigja juaj ishte se nuk është faji im por i atyre lartë, dhe unë u ndjeva mirë që ti bëre kritikë për nivelin qendror se ishte faji i qeverisë që u vonua projekt buxheti për komunën e Podujevës.

znj. Donjetë Sheqiri, theksoi, kam një pyetje për drejtorin e DBF-së, në raport figurojnë 24,000.00€ mobile për Komunën e Podujevës, siç e dimë objekti i ri i Komunës para pak kohe ka përfunduar dhe i gjithë inventari ka qenë i ri, ku kanë shkuar ajo shumë për mobile dhe për çka janë përdor.

z. Fatlum Osmani, U.D. drejtor i DBF-së, theksoi, në fillim kur e mora fjalën thash u krye diskutimi por tani po i përmbledh disa vërejtje dhe kritika të cilat u dhanë dhe rrjedhimisht më shumë ato kritika u përsëritën dhe në mënyrë që unë mos t'i përsëris arsyetimet pasi që i dëgjua më parë, tani ndoshta opinioni i vlerëson komentet, dhe këtu jemi për t'i ballafaquar argumentet.

Raportimi financiar është një shkencë në vete dhe shumë kritika sa i përket grumbullimit pse kaq pajisje, në kaq vlerë financiare, shërbime kontraktuese e të gjitha këto. Tani ta zëmë edhe raportin

financiar te institucionet publike, qëllimi pse raportohet dhe bëhet raporti financiar është në mënyrë që me pak numra të paraqitet gjendja e përgjithshme financiare e një organizate, rrjedha e parasë, rrjedha e investimeve dhe të gjitha këto sepse për ndryshe do të paraqitet çdo transaksion në formë të dokumentuar në raportet financiare, atëherë ajo është punë që duhet të diskutohet 6 muaj këtu. Qëllimi, shembull, për 4 pasqyrat financiare që janë është në 4 fletë ndoshta për miliarda qarkullime që kanë qenë, ky është qëllimi i raportit financiar, u dhanë disa kritika se çka është kjo, ajo lidhet me plan kontabël ato janë kode ekonomike nuk i përcaktojmë ne. Raporti financiar ndërtohet dhe përpilohet në bazë të kodeve ekonomike të cilat janë në plan kontabël të cilin e përpilon dhe e aprovon Ministria e Financave, përkatësisht thesari i shtetit.

z.Qëndrim Softolli, pyet se a ka mundësi të na shtjellosh këto.

z.Fatlum Osmani, vazhdon duke dhënë përgjigje, duke i shtjelluar jam, shërbimet kontraktuese çka janë që i përmende, shërbimi kontraktues është transporti i nxënësve, ta zëmë që ka një vlerë të madhe, shërbime kontraktuese janë mirëmbajtjet e ndryshme të cilat bëhen në objektet arsimore, shëndetësore, shërbim kontraktues është kontrata të cilën e kemi për hartimin e projekteve të cilën e kemi lidh në muajin maj sepse është dashur ta gjejmë të gatshme kur kemi shkuar aty në muajin janar dhe njëra prej arsyeve që e ceka është ajo këtu. Krejt këto janë shërbime kontraktuese dhe tani unë përmendësh dhe në faturë këtu nuk e kam. Te shuma 24,000.00€, këtu prapë po lidhem me plan kontabël, shembull, mobile është kur furnizohet me inventar një institucion arsimor, por është mobiluar edhe objekti i vjetër i komunës kur është adaptuar për bibliotekë të qytetit pra është bërë një furnizim me inventar edhe diçka gjatë vitit që ka pasë ndonjë blerje të vogël kështu që të gjitha këto janë që grumbullohen dhe ky është raporti ku të gjitha janë të grumbulluara.

Përndryshe logjika e raportimit financiar është kjo nuk mund të jetë ndryshe, plani kontabël, zërat, komplet transaksionet të cilat kanë ndodhur gjatë gjithë vitit kanë ndodhur me një zë të vetëm në raport financiar.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, kisha dashur shkurt të them se është e thjeshtë dhe janë terma të thjeshtë për drejtorin por raporti financiar nuk është për të, por është për ne dhe qytetarët dhe nëse këto terma dhe këto përshkrime i paraqiten qytetarëve atëherë mos e sill as raportin, s'ka kurrfarë qartësie, unë ty të kuptoj se për ty mund të jenë të qarta por për ne dhe qytetarët jo, prandaj kërkova shpjegim.

z.Fatlum Osmani, U.D. drejtor i DBF, theksoi, në krye të fjalës e ceka se ky raport financiar është i përpiluar duke u bazuar në ligjin për financat publike dhe në rregulloren për raportim financiar, është plani kontabël të cilin nuk e bëjmë ne, është Ministria e Financave, është thesari i shtetit, tash as ata nuk mund ta bëjnë ndryshe por vetëm kështu.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, nëse ndokush dëshiron fjalën urdhëroni, nëse jo atëherë e konsideroj të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës, dhe kalojmë në pikën e radhës.

11. Raporti financiar për periudhën janar – mars 2022

z.Fatlum Osmani, U.D. drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth këtij raporti, ndër të tjera theksoi, qysh në fletën e parë të përmbledhja mund ta vëreni se bëhet fjalë për raportin financiar të vitit 2022, mirëpo buxheti fillestar i aprovuar është i vitit 2021, kur dihet se ne si Komunë nuk e kemi aprovuar buxhetin në afatin kohor në muajin shtator dhe rrjedhimisht këta muaj janar, shkurt, mars, kemi operuar me buxhetin e vitit 2022. Nga këto e kemi progresin e shpenzimeve, për paga dhe mëditje janë shpenzuar 3,206,857.00€, mallra dhe shpenzime 374,988.00€, shpenzime komunale 86,617.00€, subvencione dhe transfere 62,324.00€. Te investimet kapitale gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur shpenzime, janë dy arsye, së pari në periudhën janar, shkurt, mars nuk ka investime kapitale për shkak të kushteve klimatike, mirëpo edhe arsyeja tjetër është se nuk e kemi pasë të miratuar buxhetin në muajt janar, shkurt, mars dhe rrjedhimisht nuk kemi mundësi të bëjmë pagesa nga kategoria e investimeve kapitale, ndërkohë që kategoritë tjera po thuajse kanë rrjedh në mënyrë normale meqenëse kemi operuar me 1/12 e buxhetit të vitit 2021.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, kam dy pyetje blic për drejtorin e DBF-së, kodi buxhetor 13620 furnizim me ushqim dhe pije ka një ndryshim, gjatë vitit 2021 ka 3,472.00€, kurse në vitin 2022 ka 36,351.00€, dua ta di se çka është kjo, si dhe te kodi buxhetor 13760 furnizim me dru edhe këtu është një ndryshim shumë i madh i çmimit prej vitit 2021 që është 5,775.00€, kurse në vitin 2022 janë 32,542.00€.

z.Fatlum Osmani, U.D. drejtor i DBF-së, theksoi, kategoria ushqim dhe pije meqenëse ka rritje kaq të mëdha të shpenzimeve buxhetore, bëhet fjalë se Komuna e Podujevës nga fillimi i vitit 2022 ka filluar furnizimin me ushqim për nxënësit e klasës 1-5, do të thotë furnizim me kiflet dhe këto shpenzime bëhen nga kategoria e ushqim dhe pije.

Sa i përket kodit buxhetor për nënkategorinë e lëndëve djegëse, tani mjetet buxhetore në raport financiar paraqiten për periudhën kur kanë ndodh ato shpenzime dhe kur janë furnizuar institucionet e ndryshme komunale me ato gjëra të cilat raportohen këtu. Gjatë muajit janar janë furnizuar me dru dhe pelet disa institucione arsimore dhe disa objekte shëndetësore, rrjedhimisht në këtë periudhë janë shpenzuar dhe në këtë periudhë janë paguar këto mjete dhe janë të paraqitura në këtë raport financiar. Mund të ndodhë ta zëmë se komplet shpenzimi mund të bëhet në muajin janar - mars, në një periudhë tjetër buxhetore furnizimet mund të ndodhin në muajin shtator dhe rrjedhimisht atëherë raporti paraqitet, do të thotë kur të bëhet furnizimi atëherë bëhet shpenzimi.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, te kodi buxhetor 13780 karburant për vetura ka një rritje prej 6,000.00€, në vitin 2021 kanë qenë 19,000.31€, kurse tani shpenzimet janë 25,881.00€, a mund të na tregoni përse janë rritë këto shpenzime.

z.Fatlum Osmani, U.D. drejtor i DBF-së, theksoi, edhe këtu mund të ketë ndonjë diferencë, mirëpo arsyeja kryesore është rritja e çmimit të naftës, këtu paraqita parametrat financiar e jo ata sasior.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, na keni pasë lodhë neve duke thënë se Kryetari po shkon me xhip në Prishtinë, ai xhip është edhe tani, a është më i lirë çmimi i naftës që po vozitet Kryetari me atë xhip sepse po e shohë kur po shkoj në punë në mëngjes duke ardhë Kryetari në punë, tash a është më i lirë çmimi i naftës dhe pse, e them këtë sepse na keni pas lodhë duke thënë se po shkon Kryetari me xhip në Prishtinë, jo po vjen prej Prishtinës, po vozitet xhipi, po harxhon naftë, tash do të thotë se harxhon naftë më shumë.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, nëse nuk mund ta paraqitni raportin me shifra i nderuari drejtor atëherë paraqiteni raportin në bazë të litrave.

z.Fatlum Osmani, U.D. drejtor i DBF-së, theksoi, raporti financiar nuk përcaktohet në parametra sasior, emrin e ka raport financiar.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, kur dëshiron me qenë real para qytetarëve, i sjellë edhe emrat.

z.Fatlum Osmani, U.D. drejtor i DBF-së, theksoi, shumë real jemi ky është raport financiar.

z.Avni Fetahu, U.D. drejtor i DKA-së, theksoi, për dallim nga përvoja e kaluar, ju them se për herë të parë është hap platforma E-shpenzimet dhe për herë të parë qdo shpenzim që bëhet mund të shihet, qoftë sasior, me litra dhe me mjete financiare, kështu që mos na akuzoni për jo transparencë për arsye se kjo është shumë e qartë, çdo kush mund të hyn në ueb faqe të Komunës dhe sheh shpenzimet që realizohen.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, faleminderit drejtor i DKA-së, po isha duke diskutuar me drejtorin e DBF-së, kam edhe një pyetje sa i përket kodit buxhetor 14010 mirëmbajtje dhe riparimi i automjeteve, në vitin 2021 kanë qenë 2,278.00€, kurse sot për të njëjtën periudhë kohore kemi 6,727.00€, përse tani është kjo rritje a ka të bëjë me rritjen e çmimit të naftës apo përse kemi rritje të shpenzimeve për të njëjtën periudhë kohore.

z.Fatlum Osmani, U.D. drejtor i DBF-së, theksoi, çështja është që shpenzimet e ndryshme rregullohen me kontrata kornizë dhe zakonisht mund të ketë prishje dhe elemente tjera të cilat janë riparuar, në këtë periudhë mund të ketë qenë edhe ndërrimi i gomave të automjeteve ose elemente tjera për të cilat mund të japim ndonjë sqarim por kjo është çështja. Edhe diçka që mund të ndodh shpesh ndryshon periudha e shpenzimit dhe ajo e raportimit financiar, kështu që disa ndryshime të vogla mund të jenë të kësaj natyre.

z.Valon Demolli, theksoi, dua të ndërlidhem me drejtorin e DKA-së i cili tha se po na akuzoni, nuk e di se cilës pjesë të pushtetit nuk i ka përkit ky, në çdo pushtet ky ka qenë dhe çdo akuzë që bëhet këtij i takon, nuk është ndonjë rastësi diçka.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, nëse dëshiron fjalën ndokush urdhëroni, nëse jo atëherë edhe këtë pikë të rendit të ditës e konsideroj të përfunduar, dhe kalojmë në pikën e radhës.

12. Propozim Vendimi për pezullimin e përkohshëm të zbatimit të dispozitave

Rregullores nr.prot.01-311/05-0007450/20 për orarin e punës së bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës të datës 31 janar 2020, dhe atë: neni 5

paragrafët 1.3; 2.3; dhe 4.4, neni 6 paragrafi 4, neni 7 paragrafi 2, neni 9 paragrafi 1.3, neni 12 paragrafi 2, neni 15 paragrafi 2.4; neni 16 paragrafi 2.3 dhe neni 17 paragrafi 2

z.Hilmi Hoxha, Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, lidhur me këtë rregullore më parë ka qenë një propozim për plotësim ndryshimin e saj, tani ka ardhë propozim i ri nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, unë si Kryesues i Kuvendit kam pasur kërkesa të shumta nga ana e bizneseve të ndryshme ku kemi dy grupe të biznese që kanë qëndrime të ndryshme sa i përket orarit të punës së bizneseve gjatë ditës së diel, njëri grup i bizneseve ka shpreh interesim që dita e diele të jetë ditë pune kurse grupi tjetër jo, për më shumë rreth kësaj pike faljen ia kaloj drejtorit të DPZHE.

z.Vigan Salihu, U.D. drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik-DPZHE, e paraqiti fjalën hyrëse rreth këtij propozim vendimi, ndër të tjera theksoi, arsyeja e pezullimit të nenit 5 dhe dispozitave tjera të cilat i keni parë në propozim vendim kanë të bëjnë me lejimin e ditës së diel që të jetë ditë pune por kjo nuk do të thotë se do të obligohen ato biznese që të punojnë, kjo varet nga vullneti i tyre, mirëpo të mos t'i kufizojmë që mos të punojnë, dhe kjo do të bëhet edhe për arsye sepse tani është koha e ardhjes së mërgimtarëve, si dhe në mënyrë që të kemi një lehtësim për qytetarët.

z.Gazmend Islami, theksoi, kur iu thosha qytetarëve mendoni mirë kënd po e votoni për Kryetar Komune ata nuk më dëgjuan dhe e votuan, sot po shihet mirë se cili subjekt politik ka drejtim social

demokrat, në mbrojtje të konsumatorit, në mbrojtje të vlerave të punëtorëve dhe cili subjekt politik me të vërtetë mendon drejtë për punëtorët, pra në vend që subjekti politik i cili udhëheqë në Komunën tonë të ishte shembull për mbrojtje të punëtorëve këta e ngritin një problem që ne si parti të djathta duhet t'i mbrojmë të drejtat e punëtorëve. Jo që është diskriminim total por është e pa kapshme e pa ndërgjegjshme në një kapitalizëm të egër e të poshtër të shfrytëzohet punëtori edhe në ditën e diele, andaj kënd e përfaqësoni ju (i drejtohet Grupit të LVV-së dhe Ekzekutivit), mua po më vie keq që këtu i njohë disa që janë në LVV moti se sa për drejtorin e DKA-së nuk kam çka të flas, po për juve që jeni këtu prej fillimit, kënd e mbron ju, Kryetarin, çfarë vlere mbron ju, kush jeni ju, çka përfaqëson ti, a përfaqëson LVV-në, apo përfaqëson urdhërata partiake, bash askushi nuk jeni hiç, marre duhet me ju ardhë, madje marre duhet me ju ardhë juve që jeni anëtar të vjetër prej themelimit të LVV-së, s'jeni në personalitetin tuajin, e kjo është për keqardhje.

Ky është shembulli më i keq që një parti me orientim social demokrat del dhe kërkon që ditën e diel punëtorët nëpër kompani të fuqishme që iu shtypen të drejtat e tyre për 220€ në muaj, e që Kryetari i merr 3000€, unë 5000€, ne nuk e kemi gajle këtë punë, mirëpo shko pyete atë punëtor a dëshiron që dita e diel të jetë ditë pune, do të thotë kjo është e pa ndërgjegjshme, jo që jam kundër por këtu çdo njëri duhet ta prek trurin e tij, mendjen e tij, familjen, motrat, vëllezërit e juaj që i keni nëpër puna a duhet të votoni a s' duhet të votoni këtë pikë të rendit të ditës.

I thërras të gjitha grupet e këshilltarëve pozitivë dhe opozitivë bashkërisht që këtë pikë të rendit të ditës mos ta diskutojmë por me qenë 100% kundër saj.

z.Naim Çunaku, theksoi, ashtu siç e prezantoi Kryesuesi ndoshta i hyri në hak apo nuk e di pse, por sigurisht unë sa kam informacione dhe Kryesuesi ka peticione të nënshkruara ashtu siç e kam njërën prej tyre, asgjë tjetër nëse nuk mund të bëjmë nuk mund t'i fshehim peticionet, është e vërtetë se para seancës biseduam në mënyrë shoqërore me drejtorin e Drejtorisë përkatëse që jemi në një situatë ku cilën do anë që e mbajmë njëra anë do të hidhërohet.

Pse jemi këtu, rregullorja për orarin e bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës, gjegjësisht propozimi për suspendimin e neneve të caktuara që kanë të bëjnë me pushim ditën e diel, është një prej temave që diskutohet në shumë lokalitete të Komunës sonë. Kjo rregullore është e miratuar më datë 31.01.2020, për çudi në atë kohë është votuar prej të gjitha grupeve të këshilltarëve, përjashtoj një individ që ka hezituuar ta votojë dhe në atë kohë grupet e këshilltarëve që kanë votuar janë LDK, LVV, PDK, AAK, BKD dhe PD, të gjitha këto grupe në një formë e kanë parë si zgjidhje këtë orar të punës e që një vit më pas kaluam në rrethana tjera dhe u ndërrua Ekzekutivi i Komunës si rezultat i zgjedhjeve të parakohshme, filluan vërejtjet, sygjërimet e ndryshme të grupeve të interesit që të bëjmë diçka sepse kjo rregullore faktikisht shumëçka ka çrregulluar, në veçanti ka çrregulluar konkurrencën e lirë, furnizimin e qytetarëve dhe e ka vë Komunën tonë në një pozitë jo të barabartë me Komunat tjera si motra që janë.

Atë që e ceku kolegu parafolës z.Gazmend Islami më tepër do të gjenin vend te niveli qendror andaj e mbështes në mënyrë uniforme që ta rregulloj këtë materie në nivel Kosove, por ne nuk jemi ata që mund ta bëjmë atë dhe nuk jemi përgjegjës për atë, por jemi përgjegjës këtu që sot ta marrim një vendim për një suspendim të radhës për disa nene të caktuara të rregullores, e që në seancën e kaluar një propozim të tillë e bëri kolegu z.Bashkim Sylja, pastaj ai propozim u tërhoq, tani një muaj më vonë kemi një kërkesë për pezullim të kësaj rregulloreje.

Ne Grupi i këshilltarëve të LDK-së konsiderojmë se suspendimet nuk janë zgjedhje, janë shtyrje e problemit, mendojmë se kjo rregullore edhe atëherë është dashur të trajtohet me prioritet e që dhe sot se duhet të trajtohet me prioritet, të mundohemi aq sa mundemi që t'i realizojmë interesat e bizneseve e në veçanti interesat e punëtorëve. Besoj se me një vllug më të madh të punëve duke i

ditur afatet kohore për një muaj ta rregullojmë këtë çështje njëherë e mirë që në një formë ti kënaqim sa më shumë të jetë e mundur akterët dhe grupet e interesit që i atakon kjo rregullore.

Në formën qysh është tani për një suspendim të radhës po e përsërisë atë që e thash në një fjali më parë ne Grupi i Këshilltarëve të LDK-së nuk mendojmë se kjo është zgjidhje, andaj nuk mund ta mbështesim si të tillë, do ta mbështesim çdo propozim për një rregullore të re që do ta rregullonte njëherë e mirë këtë punë.

z.Gazmend Islami, theksoi, kam një kërkesë për Grupin e Këshilltarëve të LVV-së, që të dalin me një qëndrim, pra te shohim se çka po duan për ditën e die, që të jetë ditë pune apo jo, pastaj a mund të më sqaroj dikush se a paguhet dikush shtesë që punon ditën e diel dhe për çfarë arsye duhet të lirohen bizneset të cilat fitojnë miliona e miliona euro. E them këtë sepse kërkesat janë të tyre nuk është vetëm kërkesë e ekonomive të vogla familjare, edhe pse nuk keni thënë t'i lëmë të punojnë bizneset e vogla ditën e diele dhe të përfitojnë pa iu dhënë drejtë kompanive të fuqishme të cilat e kontrollojnë gjithë tregun në Komunën tonë.

znj.Adelinë Stublla, duke i'u përgjigjur parafolësit theksoi, drejtori i Drejtorisë përkatëse i dha gjitha sqarimet në fillim dhe nëse dëshiron sqarime shtesë sërish mund t'i japë drejtori përkatës.

z.Vigan Salihu, U.D. drejtor i DPZHE, theksoi, z.Gazmend Islami po duket i mllëfosur dhe i shqetësuar dhe s'po e kuptoj përse ngase ky propozim vendim nuk është se më përket veç mua individualisht ose LVV-së ose juve, është për të gjithë qytetarët e Llapit.

E sqarova njëherë dhe po e përsëris, ne nuk jemi duke i obliguar bizneset që të punojnë, Inspektorati i Punës e ka përgjegjësinë që ta rregullojë këtë çështje se a kanë punëtorët një ditë pushim apo nuk kanë, po ashtu ata ditën e diele nuk mund ta rregullojnë në dokumentacione në punë nëse veç se e kanë ditë pushimi atë ditë ndërsa ditët tjera i kanë ditë të punës, do të thotë se kjo çështje nuk është aq shqetësuese ashtu siç u paraqit këtu dhe për këtë ti (i drejtohet Gazmend Islamit) vendos se je i thirrur dhe i votuar nga qytetarët, pastaj jemi në rregull.

Sa i përket asaj që ceku z.Naim Çunaku e sqaroj shumë mirë se kjo rregullore e ka prish konkurrencën e tregut të lirë dhe e ka çrregulluar sepse ne si Komunë jemi vonuar ngase komunat tjera po operojnë lirshëm. Drejtorja për gjatë këtyre muajve sa është e pezulluar kjo rregullore do ta përpunoj një rregullore të re dhe do ta sjellë si draft rregullore para jush këtu.

z.Xhevdet Maloku, theksoi, më bëri të flasë fjalimi i z. Naim Çunaku, dua ta di se këtë rregullore a e ka pasë edhe në seancën e kaluar apo ka ardhë me një rregullore të re sepse seancën e kaluar kur unë fola dy herë tha është shkelje e rregullores dhe nuk po e kuptoj tash a kemi të drejtë të flasim sa herë të duam ne apo e kemi të kufizuar të flasim vetëm dy herë, me cilën rregullore je duke operuar në këtë seancë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, nuk e kemi në rend dite që të diskutojmë për Rregulloren e punës së Kuvendit, andaj nuk kemi nevojë të diskutojmë për rregullore sepse thuajse të gjithë e dimë atë që me Rregullore është e paraparë që dy herë të lejohet diskutimi dhe njëherë në qoftë se të përmende emri, ke të drejtën e replikës.

z.Naim Çunaku, theksoi, këtë çështje nuk e ngrita unë, por meqë u ngrit ju sqaroj se unë diskutova vetëm njëherë në këtë pikë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, i nderuar zotëri Çunaku, emri juaj është përmendur andaj nëse ke diçka për të diskutuar mund të vazhdoesh.

z.Naim Çunaku, vazhdoi, i nderuari Kryesues, për rregulloren e orarit të punës e mora fjalën dhe atë në emër të Grupit dhe ajo ishte fjala që mora unë, jo dy herë sepse këtu kemi incizimin dhe kamerat, saktë është se unë kam të drejtë për çdo pikë të rendit të ditës të diskutoj në diskutimin primar pastaj në diskutimin plotësues pasi që të kryhet raundi. Atë që e përmendi z.Xhevdet Maloku, bëhet fjalë kur është replikë kundër replikës, është temë tjetër jashtë diskutimit.

Atë që desha ta them është si plotësim i diskutimit që kur është pyetur në një formë një pjesë të saj e tha drejtori i DPZHE që është menduar fillimisht që me anë të rregullores të rregullohet edhe dita e pushimit për punëtor, duke e përdorur si masë sigurie këtë orarin e punës, ndërsa ua humb një të drejtë të tyre, këtë isha duke e thënë, mirëpo i nderuar kur po diskutoj unë e ke marrë këtë si “alergji”, e kam thënë më parë po e them edhe tani se të drejtat dhe liritë e punëtorëve garantohen me ligjin e punës, këtë e kisha ndër mend ta them, kurse ju i nderuar Kryesues nuk ke nevojë të më thuash (jo e përmende njëherë e jo dy herë), prandaj mos më detyro tani t’i lexoj nenet e t’i marrë 10 minuta kohë. Pra edhe njëherë ju them se vetëm njëherë e mora fjalën e jo dy herë ashtu siç u tha dhe për këtë janë incizimet dhe jeni dëshmitar të gjithë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, në procesverbal do të vërtetohet kjo gjë, në qoftë se kam gabuar të kërkoj falje i nderuar Çunaku.

z.Gazmend Islami, theksoi, ti drejtor i DPZHE që jemi edhe fqinjë e që po më drejtohesh me Gaz, por si do që të jetë ne jemi koleg në Kuvend, nuk kam shqetësim të madh se a duhet punëtorët të punojnë ditën e diel por është shqetësim i madh për qytetarët dhe për çdo njërin që sa do pak lexon që një subjekt politik që udhëheq në Komunën e Podujevës me orientim social demokrat del dhe propozon që dita e diel të jetë ditë pune, ky është shqetësim i madh, do të thotë prek ndjenjën e çdo qytetari, andaj dua të them se nga kjo do të thotë se duhet ta futni në funksion logjikën se si mund të kesh karakter këtu të propozosh që t’i dërgosh në punë njerëzit ditën e diele dhe atë pa para/pagesë, për çka je kah fol ti këtu drejtor, ti s’je ai që duhet me sjellë këtë propozim këtu, ti duhet të jesh mbrojtës i të drejtave të punëtorëve ngase është kapitalizëm i egër dhe i poshtër kështu siç është tani, prandaj mendoj që kolegët e mi që vijnë nga radhët e LVV-së e që disa po heshtin këtu është për keqardhje sepse asnjëri prej tyre nuk del e ta thotë një fjalë.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, ç’është e vërteta dhe që nga praktika të gjithë e kemi vërejtur që Rregullorja në fjalë ka shkaktuar bukur shumë telashe te një pjesë e bizneseve, normalisht te pjesa më e madhe e qytetarëve të cilët kanë nevojë që gjatë ditës së diele të kenë furnizim, kurse vendimi që ju e merrni këtu sot si Kuvend është i plotfuqishëm sepse është në dorën tuaj se a dëshironi ta suspendoni apo jo. Ankesat janë të dy fishta dhe këtë e ceku edhe z.Naim Çunaku, sepse kemi njërin grup të bizneseve që dëshirojnë ditë pune ditën e diel dhe kemi grupin tjetër që dëshirojnë ta mbrojnë atë të drejtë të tyre që dita e diele të jetë ditë pushimi. E vërteta është se respektimi i kontratës së punës nuk është në domenin e kësaj rregulloreje sikurse që nuk është në domenin e Kuvendit të Komunës e as të nivelit lokal që ta rregullojmë këtë çështje ngase kjo rregullohet me ligjin e punës, është inspektorati i punës nga i cili ndoshta ne si institucion duhet të kërkojmë të jenë më azhur dhe të bëjnë kontrolle më rigorozë ndaj bizneseve që zhvillojnë afarizëm. Tani jemi në prag të sezonës verore dhe e kemi komplet pjesën e luginës së Batllavës si dhe pjesët tjera qoftë pjesa e epërme e Llapit, qoftë pjesa e luginës së Kaçandollit që bizneset kanë nevojë të operojnë sepse njerëzit kanë nevojë për shërbime, pra ata njerëz ekzistojnë edhe e presin këtë periudhë kohore që të kenë mundësi ta zhvillojnë afarizmin e tyre. Ne jemi dakord që t’i mbrojmë të drejtat e punëtorëve por kjo Rregullore nuk e zgjedh problemin e mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve dhe fundja ne askënd nuk po e detyrojmë që të punojë ditën e diel, kjo është çështje vullneti kush dëshiron mund të punoj por mund edhe të mos punoj dhe kjo nuk është obligative.

Problemi qëndron me bizneset e mëdha që kanë numër më të madh të të punësuarave, mirëpo është mirë të ulemi dhe t’i japim më shumë hapësirë vetës, pra urdhëroni edhe ju anëtar të Kuvendit bëhuni pjesë e ekipës që sot mund ta formojmë ku pjesë e saj është edhe Ekzekutivi dhe e hartojmë një rregullore të mirëfilltë e cila do të zgjedh problemet e dy anshme, të punëtorëve por edhe të qytetarëve. Ne si LVV nuk jemi duke kërkuar diçka të veçantë këtu, mirëpo jemi e vetmja Komune në nivel vendi që jemi në një situatë të tillë, madje ju e shihni se ditën e diel prej Podujevës duhet të

shkohet në fshatin Lupç për të kryer një shërbim më të voglin për çka njerëzit kanë nevojë, ndërsa nga ana tjetër ka informata e që edhe ndoshta keni mund t'i shihni se një pjesë e bizneseve janë duke funksionuar në mënyrë të fshehur, dhe për të pas mundësi mbulimi gjithë territorin e Llapit duhet të ketë ndoshta 100 inspektorë në mënyrë që të mundësohet zbatimi i tërësishëm i kësaj rregulloreje.

Çështjen e popullizmit ta lëmë këtu në Kuvend, ndërsa çështjen e përfaqësimit ne të gjithë jemi në dijeni se këndë e përfaqësojmë e në këtë drejtim edhe LVV e din se çfarë drejtimi ka dhe çfarë kahje ka dhe sa anëtar të Kuvendit ka, andaj ata që po thirren me popullizëm dihet sa janë dhe çka kanë, prandaj t'i lëmë këto gjëra "faslla". Nëse jeni dakord ta shtyjme përpara këtë rregullore mund ta pezullojmë dhe nuk ka asgjë të keqe për një ose dy muaj, mirëpo unë mendoj që është mirë të pezullojmë këtë rregullore deri në muajin shtator, e pastaj në fillim të muajit shtator ta kemi një rregullore të re, prandaj nëse keni dëshirë dhe vullnet të jeni pjesë e ekipes urdhëroni bëhuni pjesë e Kuvendit, kushdo që dëshiron nga Kuvendi bashkërisht me Ekzekutivin e hartojmë një rregullore të re, dhe aty nëse që dëshironi i ndajmë bizneset e vogla prej atyre e të mëdha ose i lëmë të punojnë ditën e diele, ose o i lëmë vetëm bizneset e mëdha, por është me rëndësi që qytetari të ketë furnizim dhe të mos ndihet i bllokuar ditën e diel. E them këtë sepse e keni vërejtur dhe po e shihni që merren komplet gjërat ushqimore në Prishtinë dhe gjatë vikendit të gjitha mbeturinat i lënë në liqenin e Batllavës, andaj të paktën të përfitojnë ato biznese të Batllavës dhe të mos merren gjitha furnizimet në Prishtinë, ndërsa ne pastaj të merremi me menaxhimin e mbeturinave sepse edhe ato biznese shpresojnë të mbijetojnë sepse kanë nevojë për të punuar, ndoshta nuk ka nevojë shumë që këtu biznesi i Podujevës ose ai në Dumnice të zëmë, por në Batllavë ka nevojë që dita e diele të jetë ditë pune. Neve na janë adresuar dhjetëra ankesa dhe kërkesa për të bërë një zgjidhje në këtë aspekt, prandaj nuk është mirë të krijohet një situatë kaotike sepse nuk është një situatë e tillë dhe nuk jemi duke bërë diçka të re, nuk jemi duke bërë unike diçka si Komunë, por jemi duke u futur në grupin e Komunave ashtu siç e kanë të rregulluar orarin e bizneseve në nivel vendi, e që një Rregullore të tillë në funksion e kanë pasë edhe Komuna e Mitrovicës dhe ajo e Vushtrrisë mirëpo e kanë larguar, ndërsa ne kemi mbetë vetmja Komunë që e kemi një Rregullore të tillë, prandaj ju lus që ta përkrahni pezullimin e përkohshëm të një numri të dispozitave të rregullores përkatëse të cilat rregullojnë orarin e punës, me theks ditën e diel, pastaj nëse dëshironi të jeni pjesë e ekipës për hartimin e rregullores së re urdhëroni jeni të mirëseardhur, ka vend për të gjithë, dhe Ekzekutivit që nga sot i japim detyra për hartimin e rregullores së re, t'i sjellin dy ose tri versione deri në muajin shtator pastaj ulemi e analizojmë se cili version mund të jetë më i mirë.

Ta kemi parasysh se tani vijnë bashkatdhetarët, po ashtu jemi në prag të festës së Bajramit dhe nëse të dielën, të hënën dhe të martën gjatë festës do të mbyllen bizneset, do të shfaqen shumë probleme, pastaj do të vijnë edhe bashkatdhetarët dhe në mungesë të zgjidhjes së këtij problemi ata do të furnizohen me mallra të ndryshëm në Prishtinë, prandaj në këtë aspekt nuk është në rregull që bizneset t'i mbajmë të bllokuara.

Sa i përket kësaj pike, askush të mos tentoj të fitoj poena politike sepse kjo çështje është e përbashkët dhe nuk mund të jetë punë dhe kontribut më i madh i askujt sepse është punë në dobi të përgjithshme, është interes i përgjithshëm dhe i përbashkët i yni. Unë nuk e shohë të nevojshme që për këtë çështje të bëhet bujë e madhe duke dalë në foltore dhe duke na treguar se kush është social demokrat, kush ka orientim të djathtë e kush orientim të majtë politik sepse i dimë ne këto gjëra.

z.Gazmend Islami, duke i'u përgjigjur Kryetarit, theksoi, shikoni nuk mundet ai të dalë në foltore këtu dhe të na filozofojë e të më treguar mua filozofi duke thënë se kjo është në interes të qytetarëve, të atyre që ma kanë dhënë votën mua. Përse nuk ia ndien këtij për punëtorët unë se kam atë problem, unë e kam hallin e atyre njerëzve që i marrin 220€, e që ky nuk i viziton kurrë.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, duke i'u përgjigjur parafolësit, theksoi, ti shkon rrinë në Gjermani atje, kurse këtu thua që ke hallin e tyre, po ta kishe hallin e tyre do të qëndroje e punoje këtu.

z.Gazmend Islami, duke replikuar me Kryetarin, theksoi, ti nuk e mbron fare asnjë të drejtë të tyre fare, shiko se çfarë telashesh po na nxjerr, interesin e kujt je duke e mbrojtur ti si person dhe zyrtar i thirrur që je, e që unë mendoj se ti je duke e mbrojtur interesin e klaneve mafioze.

Përse nuk e po e potenconi që ekonomitë e vogla të punojnë ditën e diele.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, shpresojmë se parafolësi do i mbron të drejtat e tyre, qoftë bizneseve qoftë punëtorëve.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, i nderuar zotëri Gazmend Islami, Kuvendi vendos nëse dita e diel do të jetë ditë pune ose jo, nuk vendos Kryetari por vendosin 35 anëtarë/e të Kuvendit.

U tha se ka pasë petition, shikoni unë jam këtu në Podujevë 24h dhe i kam takuar grupet e bizneseve, e kam thirr edhe drejtorin e Drejtorisë përkatëse dhe kemi pasë konsulta dhe ata përfaqësues të bizneseve kanë shpreh dëshirë që të punojnë ditën e diel sepse kanë vërejtur se ka shkelje ngase biznese të ndryshme janë duke punuar nëpër fshatra dhe lagje të ndryshme, e që ndëshkohen nga inspeksioni, kurse këtu jemi gabim sepse qytetarët kanë paraqitur kërkesat e tyre që dita e diel të jetë ditë pune kurse në bazë të rregullores nuk lejohet dhe inspeksioni është duke i dënuar ata që punojnë, kështu që ai grup dhe ata përfaqësues të biznesit ka shprehë dëshirë që dita e diel të jetë ditë pune.

Drejtori i Drejtorisë përkatëse harroj të përmend se kjo rregullore pezullohet përkohësisht deri më datë 31 shtator 2022, dhe kur ju kemi thënë këtë përfaqësuesve të bizneseve, edhe ata janë pajtuar që gjatë kësaj periudhe kohore dita e diel të jetë ditë pune pasi që vijnë edhe bashkatdhetarët në vendlindje.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuari Kryesues i Kuvendit, nuk po e di a jeni ju sponzorizues i kësaj rregulloreje apo Drejtoria përkatëse.

Kryesuesi i Kuvendit, përgjigje parafolësit, theksoi, unë i kam takuar ata njerëz dhe kam dëgjuar kërkesat dhe mendimet e tyre, sponzorizues nuk jam i asnjërit grup të bizneseve, qoftë i atij grupi që kanë shprehë vullnetin dhe dëshirën që dita e diele të jetë ditë pune, qoftë i atyre që kanë shprehë kërkesat e tyre që dita e diele të jetë ditë pushimi, kështu që nuk jam sponzorizues i asnjërës palë.

z.Ragip Fetahu, theksoi, i dëgjova me shumë vëmendje diskutimet dhe veçanërisht diskutimet e kolegut z.Gazmend Islami, mendoj se shumë gjëra janë për tu trajtuar dhe për tu diskutuar, mirëpo me të vërtetë jam i mendimit që çështjet që na kanë vënë neve në lajthitje i përkasin nivelit qendror dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale duhet ta marrë një iniciativë, ndërsa në qoftë se Ministria nuk e merr këtë iniciativë atëherë ta marrim ne dhe ta dërgojmë në Ministrinë përkatëse në mënyrë që kjo çështje dhe ky problem të zgjidhet njëherë e përgjithmonë.

Është fakt dhe shumë e vërtetë që dita e diel duhet të jetë ditë pushimi për të gjithë, të krijohet një kulturë, ai që ka harruar ta blejë një fustan apo ndonjë kravatë gjatë ditëve të javës të mos e pret ditën e diel për ta blerë. Gjithashtu është fakt se kjo Rregullore është duke na paraqitur probleme të mëdha në nivel lokal sepse kemi një ndarje të bizneseve dhe të qytetarëve në dy mendime të ndryshme, mirëpo neve si legjislativ çka na mbetet të bëjmë sepse vërtetë deri më tani unë isha në mëdyshje se çka të bëjë ngase kam pasur presione të ndryshme nga grupe të bizneseve që njëri grup thotë të punojmë, grupi tjetër të mos punojmë gjatë ditës së diele, prandaj unë mendoj dhe e mbështes idenë e Kryetarit të Komunës që kjo Rregullore të shfuqizohet përkohësisht dhe të mblidhemi ne të gjithë ta hartojmë një të re, këtë e them sinqerisht sepse herën e kaluar kemi thënë të mblidhemi por nuk jemi mbledh, prandaj të mblidhemi ta hartojmë një rregullore të re.

Në qoftë se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale nuk e rregullon me ndonjë Udhëzim Administrativ këtë çështje, na mbetet neve që ditën e diel ta bëjmë ditë pushimi nga muajt e ardhshëm. Të jetë ditë pushimi sepse krijohet kulturë e përgjithshme shoqërore që punët mos t'i lëmë në fund por t'i kryejmë me kohë dhe të paktën ta kemi një ditë pushim për familje dhe t'i përkushtohemi jetës normale.

z.Kasib Bashota, theksoi, është e vështirë për punëtorët që të punojnë edhe ditën e diel andaj nëse kjo rregullore pezullohet për një kohë, të del e të na tregoj drejtori i Drejtorisë përkatëse sepse njerëzit janë duke punuar 7 ditë të javës pa asnjë ditë pushimi, dhe atë me vite të tëra.

Konsideroj se ne si Kuvend i Komunës së bashku me Kryetarin e Komunës duhet t'i bëjmë shkresë Ministrisë përkatëse që të ndërmerren veprime për zbatimin e ligjit

z.Vigan Salihu, U.D. drejtor i DPZHE, theksoi, propozoj që kjo rregullore të pezullohet deri më datë 30 shtator 2022 pastaj ne e sjellim një draft rregullore të re.

z.Ragip Fetahu, theksoi, Atë që desha ta them është se është mirë të mbahet ky premtim dhe që të mblidhemi të gjithë dhe ta hartojmë një rregullore të re dhe mos të kemi probleme të cilat vërtetë nuk na takojnë neve.

z.Valon Demolli, në emër të Grupit të këshilltarëve, paraqiti kërkesën për pauzë të shkurtër 10 minuta, me qëllim të konsultimeve mes Grupit.

Përkrahet propozimi për 10 minuta pauzë, nga ora 15:10.

Pas pauzës, mbledhja vazhdoi duke filluar nga ora 15:25, u konstatua kuorumi ku prezent ishin 34 anëtar të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, pasi që kuorumi ekziston po vazhdojmë me punë aty ku mbetëm.

z.Arjant Topanica, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të LDK-së, duke pa se çështja e rregullores është shumë e ndjeshme dhe kohëve të fundit ka pasë shumë polemika, mendojmë se duhet të merremi pak më intenzivisht dhe më seriozisht me këtë rregullore, atëherë duke parë se pozita i ka numrat dhe ka vendosur që ta pezulloj këtë rregullore ne propozojmë që ky pezullim të jetë për një kohë më të shkurtër. Duke kuptuar rendësin e kësaj rregulloreje të punohet më intenzivisht dhe t'i japim një hapësirë kohore prej dy muajve dhe brenda këtyre dy muajve sa është e pezulluar kjo rregullore të formohet një grup punues apo një ekiye e gërshetuar ku edhe përfaqësuesit e bizneseve të jenë pjesë e hartimit të saj por edhe anëtarët e Kuvendit në mënyrë që të gjendet një gjuhë e përbashkët dhe të hartohet një rregullore që do të jetë e përshtatshme për sektorin e biznesit dhe për punëtorët si dhe të vihet në përfundim se kjo çështje është tej zgjatur.

Nuk kemi kohë të humbim në këtë drejtim për këtë rregullore, propozimi ynë është që kjo rregullore të pezullohet në afat kohor prej dy muajve dhe pas këtij afati do të sillet rregullorja e re me të gjitha detajet dhe gjitha grupet e interesit të përfshira në të.

Kryesuesi i Kuvendit, pyetje parafolësit, a keni datë konkrete të pezullimit të kësaj rregulloreje.

z.Arjant Topanica, theksoi, propozoj që si datë të caktohet 15 maj 2022, 15 korrik 2022.

z.Ragip Fetahu, theksoi, është mirë që ne të unifikohemi dhe së bashku ta hartojmë rregulloren e re, mirëpo mendoj se periudha kohore prej dy muajve është e shkurtër, andaj ne Grupi LVV-së propozojmë që koha e pezullimit të rregullores të jetë deri më datë 30 gusht 2022, që të kemi hapësirë për punë dhe t'i konsultojmë ekspertët dhe ta nxjerrim një rregullore të mirë.

z.Burim Hasani, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të AAK-së, mendojmë se periudha kohore prej dy muajve është periudhë e shkurtër, andaj propozojmë që kjo rregullore të pezullohet deri në muajin shtator. Data 15 korrik 2022 është vala më e madhe kur vijnë mërgimtarët dhe në atë kohë nuk bënë të shkaktojmë kauzë.

z.Xhevdet Maloku, theksoi, ka dy vite që kemi probleme me këtë rregullore dhe nuk besoj se për dy muaj mund t'i qasemi me shumë seriozitet kësaj rregulloreje për ta bërë një zgjidhje për të ardhmen, mendoj se duhet të kaloj një kohë më e gjatë që të punohet seriozisht në rregulloren e re dhe t'i jepe njëherë e përgjithmonë një zgjidhje kësaj çështje.

z.Ragip Fetahu, theksoi, është mirë që ne bashkërisht me rastin e votimit të pezullimi të kësaj rregulloreje t'i caktojmë edhe emrat e grupit punues nga radhët e Kuvendit të komunës që do ta hartojnë këtë rregullore në bashkëpunim me Drejtorinë përkatëse në mënyrë që ta kemi një rregullore sa më të mirë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, ju sqaroj se nuk e kemi pikë të rendit të ditës formimin e grupit punues për hartimin e rregullores se cekur, andaj këtë pikë të rendit të ditës e lëmë për ndonjë mbledhje të ardhshme dhe e formojmë komisionin nga ana e Ekzekutivit dhe Kuvendit.

Kemi dy propozime këtu, unë kisha dashur që të dalim të unifikuar ne si Kuvend, ta bëjmë një kompromis dhe të dalim me një propozim të përbashkët e jo të dalim para qytetarëve e të themi se unë thash të pezullohet dy muaj rregullorja, ose tjetri propozoj që të pezullohet dy muaj e gjysmë ta zëm, nuk dua ta lëndoj askënd që të ndihet humbës apo fitues këtu.

z.Artrit Mulliqi, theksoi, pasi që Grupi i LDK-së lëvizti prej qëndrimeve të tyre edhe ne lëvizim nga qëndrimi ynë sepse ne propozuam datën 30 shtator 2022, kurse Grupi i LDK-së datën 15 gusht 2022, do të ishte mirë që si Kuvend të dalim të unifikuar, andaj ta lëmë datën 30 gusht 2022 e që besoj se kjo datë nuk do të paraqet kurrfarë problemi.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, para se ta hedh në votim propozimin nga ana juaj, sërish dëshiroj një unifikim rreth caktimit të datës së pezullimi të rregullores sepse po e vërej vullnetin e shumicës së anëtarëve të Kuvendit që si datë të jetë 30 shtator 2022. Grupi i këshilltarëve të LVV-së, dhe Grupi i këshilltarëve të AAK-së, propozuan që rregullorja të pezullohet deri më datën 30 shtator 2022, Grupi i këshilltarëve nga LDK propozuan që rregullorja të pezullohet deri më datën 15 korrik 2022, andaj është mirë që ë gjithë ta gjejmë një kompromis dhe ta votojmë këtë pikë të rendit të ditës.

z.Ragip Fetahu, theksoi, sa për sqarim i nderuari Kryesues, ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së propozuan që rregullorja të pezullohet deri më datën 30 gusht 2022, e jo deri më datë 30.09.2022.

Kryesuesi i Kuvendit, duke i'u përgjigjur parafolësit theksoi, i nderuar, të sugjeroj të mos ngutesh në caktimin e datave sepse propozimi i drejtorit të drejtorisë përkatëse ishte që dispozita të caktuara të rregullores të pezullohet deri më datën 30 shtator 2022.

z.Bashkim Sylja, theksoi, kemi këtu dy propozime të cilat duhet të hedhen në votim.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, e ftoj edhe një herë Grupin e LVV-së që të jap propozimin e tyre.

z.Florent Hasani, theksoi, propozimi i drejtorit përkatës që ishte deri më datën 30 shtator 2022, duhet të tërhiqet nëse dëshiron ta respektoj propozimin tonë, përndryshe janë 3 propozime.

z.Ragip Fetahu, theksoi, ne tani kemi një propozim nga Ekzekutivi dhe dy propozime nga Grupet e këshilltarëve të Kuvendit, andaj ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së propozojmë që data 30 gusht 2022 të jetë fillimi i punës me një rregullore të re.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, meqenëse iniciimi i drejtorit të drejtorisë përkatëse ka qenë deri më datë 30 shtator 2022, Grupi i këshilltarëve të LVV-së propozojmë që deri më datë 30 shtator 2022, të pezullohet rregullorja në fjalë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, atëherë këtë propozim të znj.Adelinë Stublla e hedh në votim.

z.Naim Çunaku, theksoi, kemi një propozim konkret prej një Grupi, ti (i drejtohet Kryesuesit të Kuvendit) mund të votosh kundër atij propozimi, por nuk mund të mos e hedhësh në votim.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, propozimi i parë është i drejtorit të DPZHE.

z.Naim Çunaku, theksoi, atëherë i nderuar Kryesues hedhe në votim cilin do propozim, unë po të tregoj se propozimi i Grupit të e propozoj duhet të hedhet në votim, ne e kemi pasë në rend dite

propozimin e Ekzekutivit dhe ne po tentojmë ta ndryshojmë atë propozim, nëse nuk kalon propozimi ynë, atëherë kalon propozimi tjetër ashtu siç është me rend të ditës, tani po tenton ta ndryshosh rendin e ditës. Pyetje, a i hedhe në votim propozimet.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, propozimi i këshilltarit Arjant Topanica ishte për pezullimin e përkohshëm nga data 15 maj 2022 deri më 15 korrik 2022 të zbatimit të dispozitave të Rregullores nr.prot.01-311/05-0007450/20 për orarin e punës së bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës të datës 31 janar 2020, dhe atë: neni 5 paragrafët 1.3; 2.3; dhe 4.4, neni 6 paragrafi 4, neni 7 paragrafi 2, neni 9 paragrafi 1.3, neni 12 paragrafi 2, neni 15 paragrafi 2.4; neni 16 paragrafi 2.3 dhe neni 17 paragrafi 2, ishte dy muaj konkretisht prej datës 15 maj 2022, deri më datën 15 korrik, andaj këtë propozim e vë në votim.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se meqë 13 vota ishin PËR, 17 vota KUNDËR dhe asnjë votë të Përmbajtur, nuk kalon propozimi për pezullimin e përkohshëm të zbatimit të dispozitave të Rregullores nr.prot.01-311/05-0007450/20 për orarin e punës së bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës të datës 31 janar 2020, dhe atë: neni 5 paragrafët 1.3; 2.3; dhe 4.4, neni 6 paragrafi 4, neni 7 paragrafi 2, neni 9 paragrafi 1.3, neni 12 paragrafi 2, neni 15 paragrafi 2.4; neni 16 paragrafi 2.3 dhe neni 17 paragrafi 2, përkatësisht që dispozitat e cekura të pezullohen nga data 15 maj 2022 deri më datën 15 korrik 2022.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, tani e vë në votim propozim vendimin e DPZHE, për pezullimin e përkohshëm të zbatimit të dispozitave të Rregullores nr.prot.01-311/05-0007450/20 për orarin e punës së bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës të datës 31 janar 2020, sipas materialit përkatës të dërguar lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 30 anëtar/e të Kuvendit të Komunës sa ishin prezent aktualisht në sallë, me 17 vota PËR, 2 vota KUNDËR dhe 3 vota të PËRMBAJTURA, nuk kalon propozimi për pezullimin e përkohshëm të zbatimit të dispozitave të Rregullores nr.prot.01-311/05-0007450/20 për orarin e punës së bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës të datës 31 janar 2020, dhe atë: neni 5 paragrafët 1.3; 2.3; dhe 4.4, neni 6 paragrafi 4, neni 7 paragrafi 2, neni 9 paragrafi 1.3, neni 12 paragrafi 2, neni 15 paragrafi 2.4; neni 16 paragrafi 2.3 dhe neni 17 paragrafi 2, përkatësisht që dispozitat e cekura të pezullohen nga data nga hyrja në fuqi e këtij Vendimi dhe të zgjasin deri më 30 shtator 2022, si dhe me kushtatim që në mbledhjen e radhës së kuvendit të iniciohet formimi i një komisioni ad-hoc Kuvend – Ekzekutiv për hartimin e draft rregullores së re për orarin e punës së bizneseve dhe sa më shpejt të jetë e mundur të procedohet në Kuvend.

z.Naim Çunaku, theksoi, me qëllimin më të mirë dëshiroj të jap një sqarim sepse sa po e vërej, këtë çështje e keni bërë “drithë e miell”. Derisa ne sot në këtë seancë ku pjesa tjetër votoj kundër pezullimit të kësaj rregulloreje, ju sugjeroj që ta kuptoni mirë pezullimin, sepse në atë moment që kalon koha e pezullimit sërish e njëjta rregullore kthehet në fuqi, andaj nuk mund të vazhdojmë me procedura tjera. Ne nuk mund të themi se pas përfundimit të datës 30 shtator 2022 do të hyj në fuqi rregullorja e re, mirëpo më 30 shtator 2022 përfundon afati i pezullimit të kësaj aktuale, pastaj e njëjta rregullore është në fuqi, kështu duhet të jetë.

z.Artrit Mulliqi, theksoi, sa për sqarim, rregullorja nuk plotësohet tërësisht por pezullohen vetëm disa nene për një periudhë të caktuar kohore.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, edhe pse kjo pikë e rendit të ditës përfundoj me rastin e votimit, urdhëroni nëse ndokush ka për të shtuar, nëse jo kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës.

13. Informatë e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik

z.Vigan Salihu, U.D. drejtor i DPZHE, e paraqiti informatën në fjalë, ndër të tjera theksoi, sektori i planifikimit dhe zhvillimit ekonomik ka realizuar këto punë dhe aktivitete; është analizuar analiza e fizibilitetit dhe dokumentacionet tjera të nevojshme për projektin që do të zhvillohet me partneritet publiko privat përkatësisht të parkingut nëntokësor. Së shpejti do ta aprovojme partneritetin publiko privat dhe pastaj do të fillojmë me procedurat tjera për zbatimin e këtij projekti. Njëkohësisht është bërë aplikimi me projektet e komunës në thirrjet e lansuara në Ministrinë e linjës ku janë zhvilluar dhe dizajnuar projektet dhe është kompletuar i gjithë dokumentacioni i nevojshëm. Në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal është aplikuar në tri projekte dhe atë, -Podujeva për efikasitet dhe zhvillim efikas, -ndërtimi i kolektorit të ujërave të zeza përgjatë lumit Batllava deri në fshatin Lluzhan, dhe -projekti sipas të cilit Podujeva riciklon mbeturinat në partneritet me Eko-Vizionin.

Në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, në programin për zhvillim rajonal është aplikuar në projektet; -ndërtimi i stacionit të autobusëve faza e parë, dhe kërkesa për vazhdimin e projektit për vitin 2021 -ndërtimi i urave në fshatrat Sfeçël, Bajçinë dhe Gllamnik, e që deri më tani janë aprovuar projektet ndërtimi i stacionit dhe ndërtimi i urave. Pastaj po ashtu në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal është organizuar sesioni informues i këtyre projekteve të lansuara për grande për biznese start-up në koordinim me organizatën Help dhe si rezultat i Memorandum Bashkëpunimit është duke u realizuar projekti përkatësisht shpërndarja e pajisjeve për përfituesit përkatës ku kemi 22 përfitues të ndarë në sektor të ndryshëm si gastronomi, rrobaqepësi, dizajn, prodhime tekstili etj.

Në koordinim me organizatën BSKK si rezultat i lidhjes së Memorandum Bashkëpunimit në projektin aftësi dhe shkathtësi të buta për ndërmarrësi dhe marketing digjital, është duke u realizuar projekti përkatësisht blerja e pajisjeve dhe implementimi i tyre te përfituesit ku janë 14 përfitues në sektor të ndryshëm si, autolarje, zdrukhtari, rrobaqepësi, flokëtar etj.

Është iniciuar procedura e prokurimit për hartimin e Strategjisë për Zhvillim Lokal 2023-2025, mandej është iniciuar procedura e prokurimit për analizat e fizibilitetit të Zonës Industriale, është iniciuar procedura e prokurimit për botime dhe publikime, përkatësisht katalogu i parcelave për dhënie në shfrytëzim, është iniciuar procedura e prokurimit për investime në infrastrukturën e turizmit përkatësisht projekti në Parkun e Pagues, janë ofruar këshilla dhe asistencë për biznese si dhe janë mbajtur takime të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush ka për të shtuar diçka rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse jo atëherë e konsideroj të përfunduar edhe këtë pikë dhe kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës.

14. Rishqyrtimi i Vendimit nr.01-020/04-0014613/22 për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete, të miratuar nga Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2022 .

z.Hilmi Hoxha, Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, lidhur me këtë kemi të bëjmë me një vendim që është kthyer për rishqyrtim nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, arsyeja është se nuk janë zbatuar në plotëni dispozitat ligjore, kemi bërë kërkesë që të na jepet një sqarim nga ana e tyre por arsyeja kryesore është se në përbërjen e Komitetit për Komunitete nuk kemi pasë anëtar/e nga radhët e komunitetit Egjiptian. Ne kemi bërë shpalljen publike mirëpo nga ky komunitet nuk ka pasë kërkesa që të jenë pjesë e Komitetit kështu që më vonë na ka ardhë një rekomandim nga komuniteti egjiptian që anëtare e këtij komuniteti të jetë znj.Sevdije Mustafa.

Tani ne këtu jemi para dy zgjidhjeve ose ta shtojmë numrin për dy anëtar më shumë në Komitetin për Komunitete ose ta heqim nga ky komunitet një anëtar të komunitetit ashkali dhe ta zëvendësojmë me anëtarin e komunitetit egjiptian, pra kjo pikë është për rishqyrtim dhe Kuvendi për këtë merr vendim. Sa i përket anëtarëve të Komitetit për Komunitete, shumica e tyre janë nga radhët e komuniteteve jo shumicë, andaj për këtë pikë të rendit të ditës e hapim debatin.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, a ka mundësi të na sqaroni edhe njëherë këtë çështje se a është kthyer në pikën zero kjo pikë e rendit të ditës ngase se ju i nderuar Kryesues e potencuat se duhet bërë zëvendësime, të hiqet një anëtar nga komuniteti ashkali e të zëvendësohet me një anëtar tjetër nga komuniteti egjiptian, prandaj pyes se a është në rishqyrtim kjo pikë e rendit të ditës apo si.

z.Hilmi Hoxha, Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, kjo pikë e rendit të ditës është në rishqyrtim, dhe për këtë ashtu siç jeni njoftuar përmes materialit dhe thirrjes së kësaj mbledhje, madje ju është përcjellë edhe shkresa e Ministrisë.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, propozoj që përbërja e Komitetit për Komunitete të rritet për dy anëtar dhe nga Grupi i këshilltarëve të LDK-së i propozoj që të jenë Edonë Shabani dhe Demokrat Hodolli.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, lidhur me propozimin e parafolësës theksoi, besoj se mjafton një anëtar/e të jetë pjesë e këtij Komiteti.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, i nderuari Kryetar, nuk është numër i mjaftueshëm të jetë një anëtar nga LDK-ja për arsyes se jemi Grupi më i madh i këshilltarëve në Kuvend kurse nga LVV-ja janë dy anëtar në këtë Komitet, kështu që të ketë nga një anëtar nga tri subjektet me numrin më të madh të këshilltarëve në Kuvend, ose të ketë nga një anëtar nga LDK, LVV dhe AAK.

z.Haki Rudari, theksoi, unë e kam shqyrtuar dhe lexuar materialin para se të vijë në mbledhje, mirëpo sigurisht që Grupi i këshilltarëve të LDK-së po tregohet pak i pa ngopur sepse po t'ia japim edhe dy anëtar në këtë Komitet ajo do kërkon ndoshta edhe 3 apo 5 anëtar, mirëpo rregullorja nuk e lejon ashtu sepse sipas rregullores përkatëse së paku duhet të jenë 9 anëtar të Komitetit për Komunitete prej tyre 5 anëtar nga radhët e komuniteteve jo shumicë dhe 4 anëtar nga komuniteti shumicë. Ju po harroni që ne LVV jemi në pushtet me PDK-në, kurse ju jeni në opozitë, andaj unë në mënyrë kolegjiale ju thash është mirë që të propozohen dy anëtar, njëri të jetë nga radhët e LDK-së kurse tjetri nga radhët e komuniteti egjiptian, kjo është e drejtë dhe është sipas rregullores.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, ne duhet të kemi kujdes sa i përket anëtarëve të Komitetit nga radhët e komuniteteve sepse në këtë Komitet shumica e anëtarëve duhet të jenë nga komunitetet jo shumicë, gjithashtu duhet të përcaktohet edhe kuota gjinore. Konsideroj se zgjidhja më e mirë dhe më e lehtë është që në këtë Komitet të përfshihet një anëtar/e nga radhët e LDK-së dhe një anëtar/e nga radhët e komunitetit egjiptian ashtu siç është rekomanduar.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, unë e ceka propozimin e Grupit të këshilltarëve të LDK-së ngase jemi Grupi më i madh i këshilltarëve në këtë Kuvend.

Meqë kolegu parafolës nga LVV-ja u deklarua se Grupi i këshilltarëve të LDK-së janë të pa ngopur, në qoftë se LVV-së janë të ngopur atëherë le të tërheqin një anëtar dhe ta zëvendësojnë me një anëtar nga Grupi i këshilltarëve të AAK-së, dhe përbërja e këtij Komiteti të jetë me nga një anëtar të LDK-së, LVV-së dhe AAK-së.

z.Naim Çunaku, theksoi, po mundohem të jap sqarime dhe sqarimi më i mirë është se po e citoj Rregulloren dhe Statutin e Komunës mbi konstituimin e Komiteteve dhe ju kisha lutur për vëmendje. Rregullorja e punës së Kuvendit neni 79 paragrafi 2 - strukturat e komiteteve, nëse nuk parashihen ndryshe me dispozita ligjore dhe dispozita nënligjore e që ngriten në proporcion me përqindjen përkatësisht numrin e këshilltarëve të subjekteve politike apo koalicioneve të përfaqësuar në Kuvend, sipas Rregullores. Tani po e citoj Statutin e Komunës për ata që janë laik thonë se Statuti është kushtetuta e një Komune dhe kjo vlen për Ekzekutivin dhe Kuvendin, në nenin 47 thuhet, Kuvendet Komunale themelojnë Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete, si dy komitete të përhershme. Pastaj thuhet dhe këtu është poenta se Kuvendi i Komunës themelon komitete tjera për të cilat konsideron se janë të nevojshme për kryerjen e përgjegjësi të tyre nëse nuk parashihet ndryshe me ligj, pra atë që e citova më parë. Mandej thuhet se Komitetet reflektojnë përbërjen e Kuvendit të Komunës.

Çka nënkuptojmë me koalicion që u përmend, e me të vërtetë unë e di që bashkë jeni po të paktën koalicion publik nuk kam parë, por kam parë koalicion faktik. Koalicione numërohen të gjitha koalicionet të cilat janë para zgjedhjeve që garojnë në zgjedhje si të përbashkëta, këtu marrëveshjet për bashkëqeverisje nuk konsiderohen si koalicione.

Tani po mundohem ta japë edhe një sqarim tjetër zotëri Kryesues, para se të vendosim për përbërjen e Komiteteve, në rend të parë ky Kuvend duhet ta marrë vendimin që Komiteti për Komunitete të jetë në përbërje prej 9 anëtarëve, në fakt ne e kemi pasë një vendim që është zero apo nul që ky Komitet ka pasë në përbërje 7 anëtarë, tani duhet ta marrim një vendim që Komiteti për Komunitete të përbëhet prej 9 anëtarëve dhe shumicën e Komitetit prej 9 anëtarëve duhet ta përbëjnë anëtarët nga radhët e komuniteteve jo shumicë, rrjedhimisht na bie që ky Kuvend mund t'i ketë 4 anëtar/e në përbërjen e këtij Komiteti, tani nëse dëshirojmë t'i fusim në funksion ato që i ceka unë në bazë të përqindjes që kemi në Kuvend e që e dëgjova kolegun z.Haki Rudari i cili e tha se Grupi i këshilltarëve të LDK-së jemi të pa ngopur, në rregull është ngase varet se kush cilëson dhe çka cilëson, mirëpo nuk është e natyrshme, jo pse unë s'jam në LVV, por që ky subjekt 13 anëtar/e të Kuvendit t'i ketë 2 anëtar në Komitetin për Komunitete, ndërsa PDK-ja me 4 anëtar ta ketë 1 anëtar në këtë Komitet, kurse LDK-ja me 14 anëtar të quhet e pa ngopur dhe atë vetëm pse kërkoj t'i ketë 2 anëtar në Komitetin për Komunitete. Madje u dha edhe sulicionin tjetër që nëse dëshironi për me pasë një marrëveshje "gjentelmene" këtu si Kuvend që të jemi të përfaqësuar të gjitha grupimet politike, kështu aq sa unë kuptova, propozimi i znj.Donjetë Sheqiri ishte që ne e pranojmë që të gjitha Grupet e këshilltarëve të subjekteve politike që ta kenë nga një anëtar të përfaqësuar në këtë Komitet.

Kryesuesi i Kuvendit, në kërkesë të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, jap 5 deri në 10 minuta pauzë për konsultime mes vete, dhe atë brenda objektit të Komunës.

Pas pauzës prej 10 minutave, Kryesuesi i Kuvendit vazhdon mbledhjen duke njoftuar të pranishmit se në sallë janë 32 anëtar/e të Kuvendit dhe mund të vazhdohet ku mbetëm.

z.Bashkim Sylja, theksoi, propozimi u dha që LDK-ja ta ketë një përfaqësues në Komitet, dy përfaqësues t'i ketë LVV-ja dhe një përfaqësues në Komitet ta ketë AAK-ja, ndërsa ne si Grup i këshilltarëve të PDK-së heqim dorë nga propozimi që të ketë një anëtarë në këtë Komitet.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, tani besoj që jemi të qartë dhe kalojmë në propozime.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, ne i ofruam dy zgjidhje, i dhamë dy opsione dhe sërish LVV-ja po përfaqësohet më shumë në këtë Komitet, se sa LDK që ka numrin më të madh të asamblistëve, andaj unë nuk e kuptoj se me çfarë logjike doni të funksiononi kështu, ose të shkojmë me nga një propozim me nga një anëtar për secilin subjekt politik ose LDK-ja nuk ka propozim dhe vazhdoni qysh keni vazhduar seancën e kaluar, meqë edhe për faktin që na cilësuat si të pa ngopur.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, faleminderit e nderuar Sheqiri, por erdhi kompromisi që koalicioni LVV- PDK, i ka vetëm dy përfaqësues, dhe sa i përket koalicionit, kush ka sy e sheh që ky është koalicion.

znj.Donjetë Sheqiri, duke i'u përgjigjur Kryesuesit theksoi, atëherë në rregull meqë qenka koalicion.

z.Naim Çunaku, theksoi, nuk e di përse po vijmë në këso situatash ku në njërën anë kërkohet bashkëpunim, në anën tjetër nuk shfaqet gatishmëri, koalicionet i ka përcaktuar rezultati zgjedhor i zgjedhjeve, ndërsa këto janë marrëveshje të bashkëqeverisjes dhe mua kjo nuk më pengon.

Ne pranuan një solucion me një kandidat të LDK-së, por me kusht që të jenë të gjitha subjektet politike të përfaqësuara me nga një anëtar në Komitet, pra ne bëmë maksimumin që mund ta bëj një parti bashkëpunuese, por të jenë dy anëtarë nga radhët e LVV-së me 13 këshilltar në Kuvend, kurse LDK-ja që ka 14 këshilltar në Kuvend ta ketë vetëm një anëtar në Komitet, nëse i keni numrat vendosni, unë nuk mund ta kuptoj këtë.

Kryesuesi i Kuvendit, sqarim parafolësit theksoi, kompromisi ishte që PDK-ja u tërhiq nga ky Komitet.

z.Naim Çunaku, përgjigje Kryesuesit theksoi, meqë jeni në koalicion, atëher emrin e atij anëtarit të LVV-së vëjani si emër të anëtarit të PDK-së.

Kryesuesi i Kuvendit, duke replikuar me parafolësin theksoi, i nderuar këshilltar nuk është punë e juaja ajo, ju e keni një vend ne e kemi një vend.

z.Naim Çunaku, sërish replikë me Kryesuesin theksoi, punë e imja është nëse unë krahasohem me një subjekt që ka më pak numra se sa subjekti që unë i takoj, unë jam i diskriminuar nëse një subjekt më i vogël përfaqësohet me dy anëtarë në Komitetin për Komunitete, kurse ne si subjekt më i madh përfaqësohemi vetëm me një anëtar.

z.Bashkim Sylja, theksoi, është mirë të jemi korrekt i nderuar zotëri Çunaku, për ta zhbllokuar procesin ne Grupi i PDK-së u tërhoqëm kurse tani ju nuk po tërhiqeni nga propozimi juaj, mirëpo të na tregoni neve se a jemi LVV apo PDK është gabim i juaj mendoj.

z.Naim Çunaku, përgjigje parafolësit theksoi, unë nuk ju tregova juve, kurse biografinë time e di dhe nuk e fshehë, mirëpo unë të tregova ty atë që e ceku Kryesuesi se jeni në koalicion.

z.Bashkim Sylja, replikë me parafolësin, theksoi, absolutisht nuk diskutohet ajo çështje, ne këtu i kemi dy Drejtori sepse kemi koalicion.

z.Naim Çunaku, sërish replikë me parafolësin theksoi, ne ishim duke biseduar për koalicion pas zgjedhor.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, kompromisi ishte që LDK-ja ta ketë një anëtar në Komitetin për Komunitete, dhe AAK-ja të përfaqësohet me një anëtar, prandaj nuk shohë ndonjë telashe këtu.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, e përsëris sërish, më parë në fjalimin e tij para pauzës njëri nga kolegët këtu na u drejtua me fjalët, jeni të pangopur, atëherë kolegu në fjalë e ka rastin ta dëshmoj vetën se është i ngopur dhe le ta vazhdojmë procesin.

z.Haki Rudari, duke i'u përgjigjur parafolësës theksoi, ta them të drejtën ty kolege pak të njohë, LDK-në e njohë që 20 vite, vërtetë si seriozisht e thash se jeni të pa ngopur dhe tani këtë po e dëshmoni. Analizoni gjestin e PDK-së, është për çdo lëvdatë.

(Pas ndërhyrjes së bëri znj.Donjetë Sheqiri duke i'u drejtuar me pyetjen, përse nuk po kalon në PDK, z.Haki Rudari vazhdoi)

Së pari s'ke kulturë komunikimi po më vjen keq se jeni femër megjithatë s'paske kulturë të komunikimit. Unë dëgjoj dy apo pesë orë dhe nuk ndërhyj në diskutim, por kur e marrë fjalën nuk dua të më ndërhyjë askush sepse dëshiroj të flasë dhe këtë se rregullorja ma mundëson.

Nëse doni të keni përfaqësues urdhëroni, por mos thoni "valla unë jo", apo sa t'ju jepen, 10 përfaqësues a. Unë më herët ju thash mund të bëjmë shaka por ju tash po tregoheni. Qytetarët që dëgjojnë e shohin vërtetë thonë se çfarë qenka puna e tyre, me gjithë respektin për disa këtu, andaj kjo qasje e juaja, personalisht i juaj e dëmton më shumë LDK-në, e jo neve.

Ne mund të bëjmë shumë zgjidhje, është për çdo respekt PDK-ja e cila u tërhoq nga propozimi i tyre, kurse tani ju thoni ne s'po dëshirojmë të jemi pjesë e Komitetit, ju jeni opozitë pas 20 viteve dhe pse jeni opozitë arsye është se nuk keni ditë të menaxhoni mirë, ju e keni marrë faturën e qytetarëve për shkak të diskriminimeve që i keni bërë dhe tani LDK është në opozitë kurse LVV-PDK janë në pushtet, kështu që nuk mund të barazoheni me ne.

Ju është mirë që ne bëjmë përpjeke e veçanërisht unë bëra përpjekje jo zyrtarisht, që numri i anëtarëve të Komitetit për Komunitete të rritet për dy anëtar, njëri anëtar të jetë nga LDK-ja e tjetri nga radhët e komuniteteve jo shumicë, kurse tani ju propozoni t'i keni dy anëtar në këtë Komitet.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, atëherë vetë kolegu z.Haki Rudari tregoj që secilin prej neve e ka votuar dikush dhe për këtë arsye LVV-ja përfaqësohet në Kuvend me 13 asamblist, kurse LDK-ja përfaqësohet me 14 asamblist, unë vetëm po kërkoj opsionin që si partia më e madhe nuk jemi të përfaqësuar në mënyrë të barabartë, kurse ju LVV me numër më të vogël të asamblistëve të keni përfaqësues më shumë se LDK-ja e cila ka numër më të madh të asamblistëve, nuk është në rregull kjo. Sa i përket asaj se a kam unë kulturë komunikimi apo jo, mos u merakos ti për atë punë.

z.Ragip Fetahu, theksoi, ju lutem a ka mundësi që t'i përmbyllim këto polemika politike sepse përnjëmend u bë e tepërt kjo çështje. Të paktën të kemi një propozim që PDK-ja u tërhoq dhe tani jemi para një fakti që LDK-së i takon të propozoj anëtarët e saj në këtë Komitet, apo jo, dhe vazhdojmë tutje, andaj të mos e zgjasim debatin me ditë të tëra.

z.Valon Demolli, theksoi, ne i propozuam dy anëtar, tani të shohim se a po kalon një apo dy anëtar që të jenë pjesë e Komitetit për Komunitete.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, unë i propozova dy emra nga Grupi i LDK-së që të jenë pjesë e Komitetit për Komunitete, ju mund t'i hidhni propozimet në votim sikurse herën e kaluar dhe nuk është problem, mundeni të na leni pa asnjë përfaqësues në Komitet, por përgjegjësinë e bartni te qytetarët.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, faleminderit për këshillat e dhëna, mirëpo unë desha të bëjë një kompromis me juve, por ju nuk po lëni hapësirë, nuk desha që ky Komitet të mos formohet.

z.Valon Demolli, theksoi, të vëhet në votim që secili subjekt të përfaqësohet me një anëtar në Komitetin për Komunitete dhe jemi në rregull, përndryshe ne i kemi propozuar dy emra nga radhët e LDK-së.

Kryesuesi i Kuvendit, përgjigje parafolësit, theksoi, nuk kemi nevojë të hedhim propozimin e juaj në votim sepse propozimi i juaj e dini që nuk kalon.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, nëse shkojmë me propozimet që secili subjekt ta ketë një anëtar në Komitetin për Komunitete, ne nga radhët e LDK-së propozojmë që anëtar të jetë z.Demokrat Hodolli, edhe ashtu kemi të drejtë në bazë të përfaqësimit të Grupit që të parët të japim propozimin.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, për hir të korrektësisë, ne i kemi propozuar emrat dhe ata janë z.Haki Rudari dhe znj.Qendresa Hajrizi.

z.Burim Hasani, theksoi, nga radhët e Grupit të këshilltarëve të AAK-së, propozoj që anëtar i Komitetit për Komunitete të jetë z.Arbnor Fazliu.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, tani vazhdojmë me gjithë emrat e propozuar që të jenë anëtar/e të Komitetit për Komunitete. znj.Albina Avdiu, z.Xhafer Ademi, znj.Shkurte Sejdiu, z.Muhamet Sadiku, znj.Sevdije Mustafa, z.Demokrat Hodolli, z.Haki Rudari, znj.Qëndresë Hajrizi, z.Arbnor Fazliu

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 31 anëtar/e të Kuvendit të Komunës sa ishin prezent për momentin në sallë, njëzëri me 31 vota PËR, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur, konform kërkesës së Ministrisë së Pushtetit Lokal për rishqyrtim të vendimit të datës 28 shkurt 2022 që ka të bëjë me themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete, miratohet propozimi për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete me përbërjen si në vijim:

- 1- Qëndresë Hajrizi, anëtare nga radhët e Kuvendit të Komunës*
- 2- Haki Rudari, anëtar nga radhët e Kuvendit të Komunës*
- 3- Demokrat Hodolli, anëtar nga radhët e Kuvendit të Komunës*
- 4- Arbnor Fazliu, anëtar nga radhët e Kuvendit të Komunës*
- 5- Albina Avdiu, anëtare nga radhët e Komitetit Ashkali*
- 6- Xhafer Ademi, anëtar nga radhët e Komitetit Ashkali*
- 7- Shkurte Sejdiu, anëtare nga radhët e Komitetit Ashkali*
- 8- Muhamet Sadiku, anëtar nga radhët e Komitetit Rom*
- 9- Sevdije Mustafa, anëtare nga radhët e Komitetit Egjiptian*

15. Rishqyrtimi i Vendimit nr.prot.01-550/01-0014605/22 për shpërndarjen e druve të zjarrit për familjet me gjendje të rëndë ekonomike, të miratuar nga Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2022

z.Hilmi Hoxha, Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, gjithashtu kemi të bëjmë me një vendim im cili është kthyer nga Ministria përkatëse si vendim i pa ligjshëm, andaj ne si Kuvend këtë vendim duhet ta anulojmë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, masa drusore e grumbulluar nga prerjet ilegale në pyjet publike dhe private është e hyrë komunale andaj komuna menaxhon me drurët që nga momenti i ndarjes.

Në bazë të Ligjit mbi pyjet e Kosovës dhe Udhëzimeve Administrative, kjo masë drusore duhet të shkoj në ankand publik. Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-DBPZHR është e obliguar t'i përgatis kërkesë zyrës së prokurimit me të dhëna të sakta për masën e grumbulluar sipas çmimit të tregut. Çdo vendim tjetër pa marrë parasysh qëllimin e tij është në kundërshtim me ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës pasi që kjo masë drusore është e hyrë direkte e Komunës dhe pas shitjes mjetet e grumbulluara Komuna ka të drejtë t'i orientoj prapë me qëllime të njëjta për raste sociale, për bursa për nxënës dhe student, për subvencione në bujqësi etj.

Por një gjë duhet ta dini, edhe nëse vendoset që kjo masë drusore të dal në ankand publik sipas ligjit në fuqi prapë duhet që një pjesë e masës drusore të mbesë në depo me arsyetimin se për to zhvillohet procedurë gjyqësore dhe nëse pala e fiton kontestin gjyqësor duhet të kthehet masa drusore. Krejt në fund kërkoj nga DBPZHR të shikohet ligji dhe rregulloret dhe mos të përsëritet sërish e njëjta situatë ngase ne si Kuvend po dalim keq.

z.Fatmir Rudari, U.D. drejtor i DBPZHR, theksoi, faleminderit Ekrem për pyetjen, realisht ne më datë 28.02.2022 e kemi sjellë një kërkesë në Kuvend edhe pse po del që ajo kërkesë është e kundërligjshme, kemi rënë paksa në lajthitje nga komunat tjera sepse kemi komunikuar me Komunën e Ferizajt dhe disa komuna tjera dhe na është thënë që masën drusore e kanë shpërndarë përmes Kuvendit si organi më i lartë, madje për 4 vite me radhë.

Unë kur e kam sjellë kërkesën në Kuvend kam treguar që 4 herë ajo masë drusore ka kaluar përmes procedurave të prokurimit por nuk ka pasë shprehje të interesit, mirëpotani është një fat i mirë pasi që është kthyer ky vendim i jashtëligjshëm, kemi kaluar sërish përmes procedurës së prokurimit dhe ka pasur oferta dhe oferta më e lartë ka qenë 60€ m³ dhe ajo masë drusore është shitur dhe procedurat e shitjes thuajse janë në përfundim.

Se si procedohet me mjete tutje nuk e di, ju si Kuvend a mund t'i orientoni ndokund tjetër, apo të shikojmë ndonjë mundësi tjetër përmes zyrës ligjore se normalisht ato mjete janë të hyra vetanake të Komunës.

z.Demokrat Hodolli, theksoi, kam disa kërkesa prej qytetarëve të cilat do i paraqes këtu, në një qeverisje demokratike të gjithë e dimë se Komuna ofron shërbime sa më afër qytetarit, shembull e kemi për fshatrat Llapashticë dhe Dumnicë ku zyrat e gjendjes civile prej kohësh kanë qenë funksionale tani me vendimin e ri për mbylljen e tyre këtë vendim qytetarët nuk e kanë prit aspak mirë. Ju jeni thirr se ka rekomandime nga Ministria kurse në rregullore nuk specifikohet asnjë arsye për mbylljen e tyre. Gjatë fushatës zgjedhore jeni thirr se do të ofroni shërbime sa më afër qytetarit dhe po e jap një shembull, keni investuar mbi 20,000.00€ për hapjen e zyrës së gjendjes civile në fshatin Herticë mirëpo tani ajo zyrë nuk është funksionale dhe shtrohet pyetja a ka qenë ky investim i votave apo investim kot. Sa për dijeni zyra e gjendjes civile në Llapashticë e Epërme ka ofruar shërbime edhe për fshatrat e tjera (për fshatin Llapashticë e Poshtme, Katunishtë, Popovë), pra ju bëjeni vet një krahasim sa banor ka kjo pjesë dhe sa banorë ka fshati Herticë por përgjigjen se di kujt t'ia kërkoj.

z.Naim Çunaku, theksoi, kisha dashur që sot të jetë prezent këtu drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS, ngase është e vërtetë e madhe që një formë bashkëpunuese me drejtorin e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-DBPZHR jemi konsultuar para se të dal ajo formë për tu ndarë ajo masë drusore për ato grupe për njerëzit në nevojë edhe atëherë kemi shfaq dilema se a jemi në rregull me ligjin apo jo, dhe nuk kemi pritë shumë por vullneti ka qenë që ato familje të ndihmohen sa do pak dhe për gjithçka jemi në rregull, përjashtoj kritikën që më janë bërë për mos votimin e këtij propozim vendimi për shpërndarjen e druve të zjarrit për familjet me gjendje të rëndë ekonomike, andaj kisha dashur që këtu të jetë prezent edhe drejtori i DSHMS-së, t'i them se na ka rënë mirë që se kemi votuar një vendim që është kthyer i jashtëligjshëm.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, ndoshta i bëra shumë pyetje drejtorit të DBPZHR e ai harroi të jap përgjigje për një pyetje sa i përket rasteve të kontesteve gjyqësore kur dihet se ka raste që qytetarët kanë prerë dru në pronat e tyre dhe ajo masë drusore i'u është konfiskuar, andaj desha të di se a është shitur e tërë masa drusore apo jo, ngase mund të ndodh që ndonjë palë ta fitoj kontestin gjyqësor e që pastaj të njëjtit duhet t'i kthehet masa drusore.

z.Fatmir Rudari, U.D. drejtor i DBPZHR, theksoi, sa i përket masës drusore, ajo masë thuajse çdoherë ndryshon sepse kemi raste të shpeshta të konfiskimeve, ne e kemi vënë në ankand publik vetëm atë masën drusore të datës 28.02.2022, ndërsa hiqet ajo masë drusore dhe e njëjta zëvendësohet nga konfiskimet e prerësve ilegal dhe çdo herë aty ekziston një masë drusore.

Është e vërtetë ajo që e ceku z.Naim Çunaku sepse kemi diskutuar edhe në mbledhjen e KPF-së, për ndarjen e masës drusore për familjet në nevojë dhe ai propozim është mbështetur edhe nga LDK-ja,

mirëpo në mbledhjen e Kuvendit kanë marrë qëndrim që mos të marrin pjesë në votim dhe kjo është arsyeja përse nuk kanë votuar për shpërndarjen e druve të zjarrit për familjet me gjendje të rëndë ekonomike dhe nuk qëndron ajo se nuk e kanë përkrahë këtë pikë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, pas gjitha sqarimeve që u bënë atëherë e vë në votim këtë pikë të rendit të ditës, konkretisht rishqyrtimin e vendimit në fjalë sipas shkresës së Ministrisë apo thënë ndryshe ne si Kuvend duhet ta anulojmë Vendimin nr.prot.01-550/01-0014605/22 për shpërndarjen e druve të zjarrit për familjet me gjendje të rëndë ekonomike, të miratuar nga Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2022, konform shkresës së Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural e cila ka vlerësuar se akti në fjalë nuk është në harmoni me legjislacioni përkatës në fuqi.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 27 anëtar/e të Kuvendit të Komunës sa ishin prezent për momentin në sallë, njëzëri me 27 vota PËR, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur, konform kërkesës së Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pas rishqyrtimit, me vendim anulohet Vendimi nr.prot.01-550/01-0014605/22 për shpërndarjen e druve të zjarrit për familjet me gjendje të rëndë ekonomike, i miratuar nga Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2022

16. Rishqyrtimi i Vendimit nr.prot.01-354/02-0014599/22 datës 28.02.2022 për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr.01-354/02-0087371/18 datë 02.11.2018, sipas Shkresës nr. DL 1546-2/22 datë 25.03.2022 të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

z.Hilmi Hoxha, Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, arsyeja përse ky vendim është kthyer në rishqyrtim ka të bëjë me arsyetimin e vendimit konkretisht se është shtuar një pjesë e tekstit se objekti ish pushimorja për fëmijët bonjak mund të shfrytëzohet edhe për aktivitete për sport dhe rekreacion dhe nga ana e Ministrisë është cekur se kemi bërë shkelje ligjore të planit Zhvillimor të Komunës, mirëpo realisht këtu qëndron problemi te kjo pjesë e tekstit.

z.Naim Çunaku, theksoi, edhe kjo po vërtetohet që ne kemi qenë kundër shtimit apo dhënies në shfrytëzim të atij objekti për operator ekonomik dhe atëherë kemi thënë se ky objekt nuk mund të jepet në shfrytëzim për aktivitete tjera sportive dhe rekreative, por është mirë mbetet në pronësi të Komunës, madje të gjitha subjektet politike në fushatë e kanë pasë një premtim që ai objekt të funksionalizohet për ofrimin e shërbimeve paliative për personat në moshë të shtyrë, gjegjësisht për pleqëri, mirëpo atëherë ai propozim nuk kaloi. Tash besoj pasi që është anuluar ky vendim do të doja që në një mbledhje të ardhme ta orientojmë një qëllim për funksionalizimin e këtij objekti që nuk është në kundërshtim me ligjet në fuqi. Sa i përket asaj se janë shtuar dy fjalë për shfrytëzimin e këtij objekti, fjalës mik vetëm shkronjë m, po t'i hiqet bëhet ik, kështu që kushtojnë shumë ato por sido qoftë të mbetet ashtu.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, atëherë e vë në votim këtë pikë të rendit të ditës, përkatësisht anulimin e Vendimit nr.prot.01-354/02-0014599/22 datës 28.02.2022 për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr.01-354/02-0087371/18 datë 02.11.2018, sipas Shkresës nr. DL 1546-2/22 datë 25.03.2022 të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 27 anëtar/e të Kuvendit të Komunës sa ishin prezent për momentin në sallë, njëzëri me 27 vota PËR, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur, konform kërkesës së Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, pas rishqyrtimit, me vendim anulohet Vendimi nr.prot.01-354/02-0014599/22 i datës 28 shkurt 2022 për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr.01-354/02-0087371/18 të datës 02.11.2018.

17. Të ndryshme

z.Valon Demolli, theksoi, meqenëse kishim shumë pyetje për t'i bërë por "ikja" e drejtorëve të drejtorive dhe e Kryetarit të Komunës nga mbledhja, nuk kemi se kujt t'ia adresojmë këto pyetje pasi që ata nuk janë prezent këtu.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, unë po i bëj disa pyetje pasi që drejtorët nuk janë prezent le t'i shikojnë incizimet.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, kërkoj falje që po ndërhy mirëpo unë e di se kjo seancë e Kuvendit ka zgjatur shumë dhe mund të them se jemi të lodhur paksa, por nga ana juaj kërkoj vëmendje t'i dëgjojmë edhe diskutuesit e fundit sepse nuk është e ndërgjegjshme të dilet kështu nga seanca në momentet e fundit ende pa përfunduar.

z.Ekrem Rrahmani, vazhdoi, kam një kërkesë prej banorëve të fshatit Sibofc, që ka të bëjë me trotuarin e këtë e kam të fotografuar që gjendet në rrugën "Vëllazëria Ilire", në këtë trotuar deri në ditën e zgjedhjeve kanë vazhduar punimet, mirëpo kanë mbetur rreth 10 metra pa përfunduar, aty punimet nuk janë bërë siç duhet dhe nuk e di a është bërë pranimi i punës, andaj pyes përse janë ndaluar punimet, dhe përgjigjen do ta doja nga drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtim.

z.Naim Çunaku, theksoi, po mundohem të jem shumë i shkurtër, por po e paraqes një kërkesë të banorëve të lagjes Govori konkretisht rruga "Ymer dhe Nazif Ibishi", po mundohem t'ju tregoj se ajo është një rrugë që shfrytëzohet për nevojat e burgut të sigurisë së lartë në fshatin Dyz dhe ata banor janë afër kësaj rruge, janë në hall të madh nga shpejtësia që zhvillohet nga veturat e organeve kompetente dhe kërkesë e atyre banorëve është që të vendosen disa pengesa në atë rrugë sepse ndihen të rrezikuar nga qarkullimi i madh i veturave në atë pjesë të rrugës.

E di që drejtori i Drejtorisë përkatëse nuk është prezent këtu por po e përcjellë kërkesën e tyre dhe besoj se do ta ketë parasysh sepse ajo rrugë paraqet një rrezik për sigurinë e një lokaliteti konkretisht një lagjeje.

Meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 16:40

Procesverbalin e mbajtën;

Enis Sheholli

Osman Bajrami

Nr.Prot.01-060/04-0030752/22

Podujevë, datë, 29 prill 2022

**Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha**